



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Raport vjetor 2016

Vizioni

Të jemi kredibilë dhe të pranuar globalisht si rregullator dhe autoritet mbikëqyrës i aviacionit civil, i radhitur para të tjerëve në rajon dhe më gjerë sa i përket sigurisë së aviacionit.

Misioni

Të krijojmë një ambient të aviacionit civil në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	5	a) Bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar për ZHEITI.....	28
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6	b) Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës.....	29
2. BAZA LIGJORE.....	9	c) Bashkëpunimi me Ministren për Dialog.....	29
a) Përmirësimi i bazës ligjore.....	10	d) Bashkëpunimi me KFOR-in.....	30
b) Vështirësitë ligjore.....	10	e) Bashkëpunimi me KHAIA.....	30
3. PËRSHKRIMI I AAC-së.....	10	f) Bashkëpunimi me organizatat aeronautike në Kosovë.....	30
4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL.....	11	g) Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës.....	30
a) Struktura organizative e AAC-së.....	11	h) Bashkëpunimi me Zyren e Rregullatorit të Energjisë.....	30
b) Të hyrat financiare të AAC-së.....	12	7.9 AKTIVITETI I AAC-SË NË RRAFSHIN	
c) Pagat e personelit të AAC-së.....	13	NDËRKOMBËTAR.....	31
4.1 BORDI MBIKËQYRËS I AAC-së.....	13	a) Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil.....	31
a) Mandati.....	13	b) Bashkëpunimi shumëpalësh rajonal.....	32
b) Kompetencat.....	13	c) Koordinimi i asistencës teknike në fushën aviacionit.....	33
c) Funksionaliteti.....	14	7.10 AKTIVITETI RREGULLATOR.....	35
4.2 EKZEKUTIVI.....	14	a) Siguria e fluturimeve.....	35
a) Drejtori i përgjithshëm i AAC-së.....	14	b) Shërbimet e navigacionit ajror.....	41
b) Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i AAC-së.....	14	c) Aerodromet.....	46
c) Menaxhmenti i mesëm.....	14	d) Rregullimi ekonomik.....	49
4.3 BURIMET NJERËZORE.....	15	7.11 AKTIVITETI LEGJISLATIV.....	51
a) Trajnimet.....	15	a) Aktetnëligjore.....	52
4.4 ASETET.....	15	b) Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative.....	54
5. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS.....	15	c) Ndëshkime/ankesa/konteste.....	55
6. SISTEMI PËR MENAXHIM TË CILËSISË.....	16	7.12 PUBLIKIMET TEKNIKE PËR INDUSTRIJË.....	55
a) Certifikimi i AAC-së me ISO 9001:2015 dhe		7.13 INFORMIMI I PUBLIKUT DHE QASJA NË	
auditimi i jashtëm.....	16	DOKUMENTE PUBLIKE.....	56
b) Mirëmbajtja e Sistemit për Menaxhim të Cilësisë		a) Buletini i AAC-së “Aviatori”.....	56
(SMC-së).....	17	b) Qasja në dokumente publike.....	56
7. PUNA GJATË VITIT PARAPRAK.....	17	c) Faqja zyrtare e AAC-së në internet.....	56
7.1 PËRPPJEKJET PËR ANËTARËSIM TË REPUBLIKËS SË		7.14 ADMINISTRATA DHE BURIMET NJERËZORE.....	56
KOSOVËS NË ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË TË		a) Prokurimi gjatë vitit 2016.....	57
AVIACIONIT.....	17	7.15 RAPORTI FINANCIAR.....	58
a) Organizata Ndërkombëtare Aviacionit Civil (ICAO).....	17	a) Raporti i buxhetit me shpenzime.....	58
b) ECAC dhe EUROCONTROL.....	18	b) Të hyrat.....	59
c) EASA.....	18	c) Shpenzimet buxhetore.....	59
7.2 NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE TË KOSOVËS.....	19	d) Planifikimi / Realizimi i buxhetit.....	61
a) Përshkrimi i hapësirës ajrore të Kosovës.....	19	e) Investimet kapitale.....	62
b) Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së		f) Tabelë krahasuese e buxhetit për tre vitet e fundit.....	62
Kosovës.....	22	g) Buxheti i AAC-së për vitin 2017.....	62
7.3 MARRËVESHJA MBI HAPËSIRËN E PËRBASHKËT		8. AUDITIMET NDAJ AAC-së.....	63
EVROPIANE TË AVIACIONIT (MARRËVESHJA HPEA).....	23	a) Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	
7.4 PROGRAMI SHITËTËROR I SIGURISË (PSHS).....	24	të Kosovës.....	63
7.5 AUDITIMI VLERËSUES I AEROPORTIT TË GJAKOVËS.....	25	b) Auditimi i Brendshëm nga Ministria e Financave.....	63
7.6 ÇËSHTJET E AVIACIONIT TË NDËRLIDHURA ME		9. STATISTIKAT E TRAFIKUT AJROR.....	63
INTEGRIMIN EVROPIAN.....	27	SHTOJCA 1 - LISTA E TRAJNIMEVE.....	65
a) Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.....	27	SHTOJCA 2 - PLANI I VEPRIMIT I AAC-SË PËR	
b) Raporti i Vendit për Kosovën i Komisionit Evropian.....	27	VITIN 2016 DHE REALIZIMI I TIJ.....	72
c) Takimi sektorial dhe plenar i transportit në kuadër të		SHTOJCA 3 - REZULTATET E MATJESË KËNAQSHMËRISË.....	78
DPSA-së.....	27	SHTOJCA 4 - STATISTIKAT E TRANSPORTIT AJROR.....	79
7.7 REAGIMI NDAJ NDIHMËS SHITËTËRORE TË			
MAQEDONISË OFRUAR KOMPANIVE AJRORE.....	28		
7.8 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL.....	28		

LISTA E SHKURTESAVE

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës
AMC	Qendra e Mjekësisë së Aviacionit
AME	Ekzaminues Mjekësor të Aviacionit
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
BE	Bashkimi Evropian
BNRREA	Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rregullimi ekonomik i aviacionit
EASA	Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit
ECAC	Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil
EUROCONTROL	Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigacionit Ajror
HPEA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit
IATA	Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Instrumenti i Para-anëtarësimit
ISIS	Zbatimi i Qiellit të Vetëm Evropian në Evropën Juglindore
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
KA	Kontrolli Ajror
KE	Komisioni Evropian
KFOR	Forcat e Kosovës
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
KPM	Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës
KTa	Kontrolli i Trafikut Ajror
LAC	Ligji për Aviacionin Civil
LKIA	Kompania private që operon ANP “Adem Jashari”
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
PSHS	Programi Shtetëror i Sigurisë
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SMC	Sistemi për menaxhimin e cilësisë
SPR	Standardet dhe praktikat e rekomanduara të ONAC-it
SHNA	Shërbimet e navigacionit ajror
ZAPK	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës
ZSC	Zyra për Siguri dhe Cilësi në AAC

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është agjenci e pavarur rregullatore e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik; është organizatë e vetëfinancuar buxhetore dhe autoritet publik, i cili iu nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

AAC-ja vetëfinancohet nga të ardhurat e dedikuara, siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar). Sipas Nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ardhurat e dedikuara të AAC-së përbëhen nga:

- taksat të cilat ndërlidhen me aviacionin, detyrimet dhe tarifet;
- një përqindje nga shërbimet e navigacionit ajror që ofrohen brenda hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës;
- tarifet për sigurinë e pasagjerëve dhe tarifet e certifikimit dhe licencimit; dhe
- donacionet, grantet dhe përkrahjet (mbështetjet) tjera financiare ose teknike të caktuara për AAC-në.

AAC-ja udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm. Drejtori i përgjithshëm i AAC-së është riemëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 8/157 të datës 22 nëntor 2013 për një mandat pesëvjeçar me mundësi vazhdimi. Puna e AAC-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës prej pesë anëtarësh. Bordi i ri Mbikëqyrës i AAC-së është emëruar nga Qeveria në qershor të vitit 2016.

Në fillim të janarit 2016, pas një konsultimi gjithëpërfshirës, është konsoliduar dhe miratuar i gjithë Plani i punës i AAC-së për vitin 2016. Ky plan në përmbajtje përfshin: planin e veprimit, planin e aktiviteteve mbikëqyrëse, planin e rekrutimit dhe planin e trajnimeve të personelit dhe është në përputhshmëri të plotë me objektivat strategjike të AAC-së. Rishikimet tremujore dhe ai vjetor kanë treguar se plani i punës për vitin 2016 është realizuar 91%, përkatësisht plani i veprimit është realizuar 84%, plani i trajnimeve 100% dhe plani i aktiviteteve mbikëqyrëse 90%. Shtojca 2 e këtij raporti përmban planin e punës 2016 dhe realizimin e tij.

Kompania audituese për certifikim sipas standardit ISO, TUV Austria ka audituar në nëntor Sistemin për Menaxhim të Cilësisë në AAC, të ngritur sipas standardit më të fundit ISO 9001:2015. Auditimi ka rezultuar pa asnjë gjetje dhe si rrjedhojë AAC-ja është certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015 deri në nëntor të vitit 2019. Për të mirëmbajtur sistemin e menaxhimit të cilësisë, në dhjetor, për të pestën herë me radhë është realizuar matja e kënaqshmërisë së shfrytëzuesve të shërbimeve që ofron AAC-ja. Nga përgjigjet e pranuar është krijuar një mesatare e vlerësimit që arrin vlerën 4.44 në vitin 2016 (vlerat matëse nga 1 deri në 5). Në Shtojcën 3 janë paraqitur rezultatet e matjes së kënaqshmërisë.

Në qershor, Qeveria e Republikës së Kosovës ka emëruar Komitetin e Programit Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit Civil, kryesues i të cilit është Drejtori i përgjithshëm i AAC-së, ndërsa anëtarë janë emëruar përfaqësues të autoriteteve publike me përgjegjësi në politikat dhe sigurinë e aviacionit civil. Komiteti është përgjegjës për mënyrën e menaxhimit të sigurisë së aviacionit civil në nivel vendi dhe për këtë qëllim ka miratuar Manualin e Programit Shtetëror të Sigurisë, siç raportohet në pikën 7.4 të këtij raporti.

NATO-ja ka vazhduar të udhëheqë bisedimet gjatë vitit 2016 me autoritetet shtetërore të Kosovës dhe vendeve fqinje për të normalizuar edhe hapësirën e ulët ajrore të Kosovës. Normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, ndër të tjera, do të përfshijë hapjen e korridoreve të reja ajrore midis Republikës së Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë, që do të shërbenin për të gjithë avionët që fluturojnë në ANP "Adem Jashari". Tash për tash, të gjitha fluturimet në Prishtinë kryhen vetëm përmes një korridori ajror që lidh Republikën e Kosovës me Maqedoninë. Korridoret e reja do ta shkurtonin kohën e fluturimit për rreth 15-20 minuta, do ta ulnin koston e operimit për kompanitë

ajrore, që rrjedhimisht, do të duhej të reflektuhej në bileta më të lira për udhëtarët tanë. Gjatë dy takimeve të mbajtura në vitin 2016, palët janë pajtuar që në vitin 2017 të fillohet dialogu teknik midis ekspertëve, i lehtësuar nga NATO, për hapjen e korridoreve ajrore, që përfshin një varg veprimesh teknike.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim midis Republikës së Kosovës dhe BE-së në tetor të 2015-s i ka hapur rrugë, pas shumë vitesh kërkesë, takimit midis AAC-së dhe Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA). Si rezultat i këtij takimi, auditorët e EASA-s ndërmorën për herë të parë një vlerësim gjithëpërfshirës në Kosovë në nëntor të vitit 2016. Ky auditim, mes tjerash, ka shërbyer si mision faktmbledhës para nënshkrimit formal të Aranzhimeve të Punës midis Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit gjatë vitit 2017. Nënshkrimi i aranzhimeve të punës do të mundësojë, përveç tjerash, auditimet e performancës së AAC-së nga EASA dhe një vlerësim pozitiv do të garantonte njohje në nivel panevropian të licencave dhe certifikatave të aviacionit të lëshuara nga Republika e Kosovës.

Në janar, një ekip ekspertësh të KE-së ka ndërmarrë një vizitë vlerësuese mbi nivelin e zbatimit të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA) në Republikën e Kosovës. Ekspertët kanë vlerësuar autoritetet aeronautike të Kosovës (AAC-në, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike) si dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me disa dispozita të Ligjit të Punës, dhe Autoritetin Kosovar të Konkurrencës lidhur me mbrojtjen e konkurrencës dhe ndihmën shtetërore në Kosovë. Operatori i ANP "Adem Jashari" si dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror poashtu i janë nënshtruar vlerësimit. Raporti nga ky vlerësim konfirmoi progresin e konsiderueshëm të bërë nga Kosova për zbatimin e kërkesave të Marrëveshjes, jo vetëm për sa i përket fazës së parë tranzitore, por edhe të dytës. Raporti i Vendit i vitit 2016 i publikuar nga KE-ja në nëntor, poashtu konfirmoi progresin thelbësor në përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në fushën e aviacionit civil, respektivisht të legjislacionit që është kërkesë nga Marrëveshja HPEA.

Kosova më 2016 ishte nikoqire, për herë të parë, e takimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Komiteti i Përbashkët është organi më i lartë mbikëqyrës i Marrëveshjes HPEA, në të cilin Komisioni Evropian, përfaqësues të shteteve të Ballkanit Perëndimor, përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së si dhe përfaqësues nga industria e aviacionit diskutojnë përparimet dhe sfidat në mes dy takimesh vjetore. Në takim, Drejtori i përgjithshëm i AAC-së ngriti shqetësimin mbi konkurrencën jolojale nga Aeroporti i Shkupit, me të cilën po ballafaqohet Aeroporti i Prishtinës për shkak të subvencioneve që Qeveria e Maqedonisë po vazhdon t'ia ofrojë një kompanie ajrore që operon në Shkup e që po reflektohen në çmime joarsyeshëm të ulët biletash fluturimi, të cilat po i tërheqin në masë të madhe udhëtarët nga Kosova. AAC-ja, siç mund të lexohet në pikën 7.7 të këtij raporti, ka ngritur këtë çështje në vazhdimësi në Komisionin Evropian, shërbimet e të cilit po merren me analizimin e ligjshmërisë së ndihmës shtetërore të Maqedonisë.

AAC-ja ka vazhduar të bashkërendojë aktivitetet me MPJ-në dhe MI-në mbi veprimet që duhen ndërmarrë për anëtarësimin në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) si dhe ka vazhduar përpjekjet që të marrë pjesë si vëzhguese në punimet e organizatave të rëndësishme panevropiane të aviacionit ECAC dhe EUROCONTROL. Më tepër për këtë temë mund të lexohet në pikën 7.1 të këtij raporti.

Një aktivitet i shtuar i një rëndësie të veçantë rregullatore ka ndodhur në fushën e shërbimeve të navigacionit ajror. Në gusht, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) u certifikua për herë të parë nga AAC-ja pas konfirmimit që janë përmbushur të gjitha kriteret e sigurisë, ekonomike-financiare dhe të sigurimit që kërkohen me dispozitat e BE-së për certifikimin e ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. AAC-ja gjithashtu ka përcaktuar tarifën terminale të navigacionit ajror për vitin 2017, e cila do t'u ngarkohet kompanive ajrore që marrin shërbime terminale të navigacionit ajror nga ASHNA. Përcaktimi i tarifës është bërë në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së, sipas të cilit ASHNA duhet të jetë në gjendje që përmes të hyrave nga tarifa terminale e navigacionit të mbulojë kostot operative dhe kostot tjera të nevojshme për të dhënë shërbimin. Poashtu, për herë të parë, AAC-ja, me kërkesë të KE-së ka hartuar Planin fillestar të performancës për shërbimet e navigacionit ajror për

vitet 2017-2019, në të cilin parashihet planifikimi afatgjatë i performancës dhe vendosja e caceve të performancës në katër fusha kyçe: siguri, kapacitet, mjedis dhe kosto.

Në rrafshin legjislativ, AAC-ja ka vazhduar të nxjerrë akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil, me të cilat bëhet përvetësimi i standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil të publikuara nga ICAO-ja dhe atyre për zbatim të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit civil, si ato në kuadër të Marrëveshjes HPEA, ashtu edhe të tjerat të cilat vlejné për vendet e BE-së, por që ende nuk janë bërë zyrtarisht pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Janë nxjerr katër dhe janë hartuar nëntëmbëdhjetë akte tjera të veçanta nënligjore për transponimin e legjislacionit të BE-së dhe rregullave të ICAO-s në fusha të ndryshme brenda përgjegjësisë së AAC-së. Përpos këtyre rregulloreve dhe disa publikimeve teknike që i shërbejnë industrisë për zbatim më të lehtë të rregulloreve, AAC-ja gjatë vitit ka publikuar edhe dy raporte të rëndësishme: i pari, i rregullt vjetor, mbi ndodhitë e raportuara në AAC, dhe i dyti mbi Aeroportin e Gjakovës. Ky i fundit përshkruan në detaje gjendjen aktuale të infrastrukturës, ndriçimit dhe pajisjeve të navigacionit ajror në këtë aeroport. Ekipi auditues i AAC-së ka vërejtur me kënaqësi se, ndonëse aeroporti ka qenë jashtë funksionit për dy vite me radhë që nga largimi i KFOR-it italian, stafi i Aeroportit, me një përkushtim të veçantë ishte përkujdesur për ruajtjen e sistemeve dhe dokumentacionit përcjellës. Raporti i auditimit të Aeroportit të Gjakovës mund të shërbejë si bazë e mirë për institucionet relevante shtetërore ose investitorët potencialë me rastin e përcaktimit të planit zhvillimor të këtij aeroporti.

Inspektorët e AAC-së kanë kryer inspektime dhe auditime sipas planit të miratuar të aktiviteteve mbikëqyrëse për vitin 2016 për të garantuar që operimet e aviacionit civil në Republikën e Kosovës kryhen në përputhje me standardet në fuqi. Këto inspektime dhe auditime janë bërë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në kompanitë e huaja ajrore që operojnë në Prishtinë, në operatorin e miratuar për furnizim me karburante në Aeroportin e Prishtinës si dhe në organizatat trajnuese në fushën e aviacionit civil, të aprovuara nga AAC-ja. Inspektimet kanë treguar që operimet kryhen në përputhje me standardet e sigurisë.

Në përmbushje të përgjegjësisë së licencimit të personelit me përgjegjësi të ndjeshme për sigurinë e aviacionit civil, AAC-ja ka lëshuar një numër licencash, duke përfshirë këtu edhe licencimin e kontrollorëve të trafikut ajror në bazë të kërkesave të BE-së. Ka vazhduar edhe licencimi i pilotëve dhe instruktorëve të paraglajdit.

AAC-ja ka përkrahur institucionet tjera përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i aviacionit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Vlen të përmendet përkrahja dhënë Ministrisë së Infrastrukturës në lidhjen e memorandumit të mirëkuptimit për shërbime ajrore me Hungarinë si dhe në grupin punues për hartimin e strategjisë së aviacionit civil. Përkrahje i është ofruar edhe Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore me rastin e hetimit të aksidentit të kompanisë ajrore “Turkish Airlines” në pistën e Aeroportit të Prishtinës. Koordinimi nuk ka munguar me Policinë e Kosovës në rastet kur janë operuar dronët pa autorizimin e AAC-së ose kur individë të ndryshëm kanë drejtuar dritën laser në mjetet ajrore gjatë fluturimit. AAC-ja ka përkrahur edhe Ministren për Dialog në kuadër të hartimit të strategjisë për dialogun eventual me Serbinë në fushën e transportit ajror dhe hapjes së korridoreve të reja ajrore me vendet e rajonit, duke përfshirë edhe Serbinë.

Bashkëpunimi teknik me autoritetet homologe në rajon dhe më gjerë, posaçërisht me Shqipërinë, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016. Takimet midis AAC-ve të rajonit në kuadër të Iniciativës për krijimin e Zonës së Përbashkët për Ofrimin e Shërbimeve (JSPA) janë fokusuar në shkëmbimin e ekspertëve të shërbimeve të navigacionit ajror midis autoriteteve.

AAC-ja investon në ngritjen e vazhdueshme dhe mbajtjen e kapaciteteve profesionale të personelit të vet, në përputhje me standardet dhe praktikën e rekomanduara ndërkombëtare. Në bazë të një plani



trajnimesh të miratuar paraprakisht, gjatë vitit 2016 personeli i AAC-së ka ndjekur trajnime, kryesisht të financuara nga donatorët, si dhe trajnime të financuara nga buxheti i AAC-së. Lista e detajuar e trajnimeve ndodhet në Shtojcën 1 të raportit.

Edhe për vitin 2015, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAPK) ka dhënë Opinion të Pamodifikuar dhe ka konfirmuar se “pasqyrat financiare të AAC-së për vitin 2015 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale”. Sipas këtij raporti, menaxhimi i buxhetit është bërë në harmoni të plotë me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. ZAPK-ja ka dhënë dy rekomandime, të cilat AAC-ja i ka adresuar menjëherë dhe i ka zbatuar sipas dispozitave në fuqi.

Buxheti i AAC-së për vitin 2016, pas shkurtimeve buxhetore, ishte 832,556 €. Gjatë vitit fiskal 2016, AAC-ja ka shpenzuar 832,147 €, që do të thotë se realizimi në përqindje është 99.95% e buxhetit të alokuar/miratuar. Mospërmbushja 100% e buxhetit është për shkak të kursimeve për shërbime komunale. Ndërkaq, të hyrat e AAC-së kanë arritur vlerën prej 1,715,809 €.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” ka shërbyer gjithsej 1,744,202 udhëtarë në vitin 2016, sipas statistikave që ka mbledhur operatori LKIA. Ky numër udhëtarësh është 12.59% më i lartë se numri i udhëtarëve që janë shërbyer në këtë aeroport në vitin 2015 (1,549,198). AAC-ja, në zbatim të përgjegjësi të veta për rregullimin e tarifave aeronautike në aeroport, ka miratuar në shkurt të vitit 2016 një skemë nxitëse të propozuar nga operatori i ANP-së që konsiderohet të ketë pasur ndikim në hyrjen e operatorëve të ri në treg dhe në shtimin e trafikut gjatë vitit. Grafikonët e statistikave të trafikut ajror për në/nga Kosova janë paraqitur në Shtojcën 4 të raportit.

2. BAZA LIGJORE

Më 13 mars 2008, Parlamenti i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 3/L-051 për Aviacionin Civil. Ligji ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në pajtim me nenin 130 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili kërkon themelimin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Ligji për Aviacionin Civil është ligj bazik i funksionimit të AAC-së dhe rregullimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Me këtë ligj AAC-së i janë dhënë kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore në formë të rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe vendimeve, me të cilat janë zbatuar më konkretisht dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil. Funksionimi dhe organizimi i brendshëm është bërë me rregulloren e brendshme të nxjerrë nga Drejtori i përgjithshëm, në bazë të nenit 14.2 të Ligjit për Aviacionin Civil dhe sipas legjislacionit në

fuqi, duke përfshirë Ligjin për Administratën Shtetërore, Ligjin për Shërbimin Civil dhe rregulloret e Qeverisë së Kosovës për shërbimin civil.

a) Përmirësimi i bazës ligjore

Ligji për aviacionin civil është një ligj që i takon grupit të parë të ligjeve pas pavarësisë. Plotësimin/ndryshimin e ligjit, nëse është e nevojshme, duhet ta iniciojë Ministria e Infrastrukturës, si ministri e linjës, ndërsa hisedarë të këtij procesi duhet të jenë AAC-ja, MPB-ja dhe KHAIA. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur iniciativë legjislative në drejtim të ndryshimit/plotësimit të ligjit, duke marrë parasysh edhe vlerësimet e vazhdueshme të Komisionit Evropian se Ligji i Aviacionit Civil i Kosovës është në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së dhe se mund të shërbejë si model për shtetet tjera të rajonit.

b) Vështirësitë ligjore

Siç u tha më lart, Ligji për Aviacionin Civil dhe aktet nënligjore që burojnë prej tij i kanë mundësuar AAC-së ushtrimin e përgjegjësiave të veta dhe zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të vendit në fushën e sigurisë pa ndonjë vështirësi për t'u theksuar.

3. PËRSHKRIMI I AAC-së

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës është themeluar në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 3/L-051 për Aviacionin Civil. Nga 1 janari 2009, AAC-ja ka marrë kompetencat e plota në përputhje me këtë ligj. AAC-ja është njëra nga autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksione në fushën e aviacionit civil në vendin tonë. Ligji përcakton që Ministria e Infrastrukturës (MI) është përgjegjëse për rregullimin ekonomik të transportit ajror¹, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjëse për rregullimin e aspekteve të sigurimit të aviacionit.² Ligji gjithashtu themelon Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), si institucion që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.³

AAC-ja është një agjenci e pavarur rregullatore, e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë. AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. AAC-ja është organizatë e vetëfinancuar buxhetore dhe autoritet publik dhe iu nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

AAC-ja është përgjegjëse për:

- zbatimin e legjislacionit mbi aviacionin civil dhe zbatimin e politikave të miratuara nga MI-ja ose Qeveria në fushën e aviacionit civil;
- ofrimin e këshillave dhe propozimeve për MI-në, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e aviacionit civil;
- nxjerrjen e rregulloreve zbatuese dhe urdhrave të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil dhe Marrëveshjen mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, me qëllim të zbatimit të politikave të aviacionit civil të MI-së dhe legjislacionit përkatës nga fusha e aviacionit civil;
- lëshimin e licencave, certifikatave dhe lejeve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së të përcaktuara nga Ligji për Aviacionin Civil;

¹ Ligji për Aviacionin Civil, Kreu 2

² Po aty, Kreu 4

³ Po aty, Neni 5

- rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;
- rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror;
- ofrimin e këshillave për MI-në në lidhje me përgatitjen nga Ministri të propozim-politikave mbi shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës, të cilat i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve, duke pasur parasysh sigurinë kombëtare, faktorët ekonomikë dhe mjedisorë dhe nevojën për standarde të larta të sigurisë;
- mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhrave të aviacionit civil, përveç kur, me Ligjin për Aviacionin Civil ose me një akt tjetër themelor juridik, ky funksion shprehimisht i është dhënë MI-së ose një autoriteti tjetër publik;
- shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC-së;
- marrjen e masave, kryerjen e hetimeve dhe inspektimeve dhe nxjerrjen e urdhrave, rregullave, rregulloreve dhe/ose procedurave të cilat AAC-ja me arsye i konsideron të nevojshme për (i) zbatimin e rregullt dhe të ligjshëm të dispozitave të Ligjit për Aviacionin Civil ose (ii) ushtrimin e rregullt dhe të ligjshëm të kompetencave dhe detyrave të cilat i janë dhënë AAC-së me këtë ligj; dhe
- ushtrimin e funksioneve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me aviacionin civil në Kosovë që i janë dhënë AAC-së sipas Ligjit për Aviacionin Civil ose një akti tjetër themelor juridik.

4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL


Selia e AAC-së është në Prishtinë, Lagjja Arbëria, rruga “Ahmet Krasniqi” p. n. Zyrat e AAC-së kanë hapësirë të mjaftueshme për t’iu siguruar punonjësve kushte të mira për punë. Pasiqë zyrat e AAC-së janë të vendosura në një objekt privat, për të cilin paguhet qira, AAC-ja në vazhdimësi ka kërkuar nga Ministria e Administratës Publike të gjejë një zgjidhje për vendosjen e AAC-së në një objekt të përshtatshëm shtetëror, ose për ndarjen e një trualli në qytetin e Prishtinës për ndërtimin e objektit administrativ të AAC-së.

a) Struktura organizative e AAC-së

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës, struktura organizative e AAC-së përbëhet nga:

- a) Zyra e Drejtorit të përgjithshëm
 - i. Drejtori i përgjithshëm
 - ii. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm
 - iii. Zyra për siguri dhe cilësi
 - iv. Zyra për çështje ligjore të aviacionit
 - v. Zyra për marrëdhënie me publikun
- b) Departamenti i sigurisë së fluturimeve
- c) Departamenti i shërbimeve të navigacionit ajror
- d) Departamenti i aerodromeve
- e) Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rregullim ekonomik të aviacionit
- f) Departamenti i administratës dhe burimeve njerëzore

Në vazhdim është skema organizative e AAC-së, në përputhje me Rregulloren e funksionimit të brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës.



b) Të hyrat financiare të AAC-së

AAC-ja vetëfinancohet nga të ardhurat e dedikuara, siç përcaktohen në Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i plotësuar dhe ndryshuar). Sipas Nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ardhurat e dedikuara të AAC-së përbëhen nga:

- taksat të cilat ndërlidhen me aviacionin, detyrimet dhe tarifët;
- një përqindje nga shërbimet e navigacionit ajror që ofrohen brenda hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës;
- tarifët për sigurinë e pasagjerëve dhe tarifët e certifikimit dhe licencimit; dhe
- donacionet, grantet dhe përkrahjet (mbështetjet) tjera financiare ose teknike të caktuara për AAC-në.

Që nga 1 janari 2009 zbatohet Rregullorja nr. 2008/7 e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit për përcaktimin e tarifës së sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova. Kjo Rregullore përcakton një tarifë sigurie prej 2 eurosh për çdo udhëtar që niset nga Kosova me fluturime komerciale. Sipas Ligjit për Aviacionin Civil dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje, fondet e mbledhura nga kjo tarifë sigurie janë të ardhura të dedikuara për AAC-në me qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative.

Duke filluar nga gjysma e vitit 2011, AAC-ja përmes Rregullores nr. 7/2011, të ndryshuar me Rregulloren nr. 2/2015, ka siguruar bazën ligjore për mbledhjen e tarifave për shërbimet të cilat ajo i ofron, që përfshijnë dhënien e licencave, lejeve, certifikatave të ndryshme dhe kryerjen e inspektimeve dhe auditimeve, në përputhje me kompetencat e AAC-së për rregullimin e aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Të dhënat e hollësishme për të hyrat e AAC-së në vitin 2016 janë paraqitur në pikën 7.15 (b) të këtij raporti.

c) Pagat e personelit të AAC-së

Siguria e aviacionit civil është misioni dhe prioriteti numër një i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Si rregullator i aviacionit civil, AAC-ja siguron që operimet ajrore në Republikën e Kosovës kryhen në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe standardet ndërkombëtare, duke përfshirë legjislacionin dhe standardet e aviacionit në Bashkimin Evropian. Për ta arritur këtë mision, një rregullator i aviacionit civil ka nevojë për personel shumë të kualifikuar dhe me përvojë për t'i hartuar standardet, procedurat, rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga operatorët përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme, inspektimeve dhe auditimeve.

Sipas Nenit 24.2 të Ligjit për Aviacionin Civil, pagat e personelit të AAC-së caktohen nga Ministri i Financave, me propozim të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së. Në caktimin e nivelit të pagave, ligji përcakton që, përveç kritereve profesionale për personelin, duhet të merren parasysh edhe pagat e personelit të industrisë së aviacionit (aeropotit, kontrollit të trafikut ajror, kompanive ajrore), parim ky i kërkuar edhe nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO). Niveli i pagave të personelit të AAC-së është miratuar më 20 mars 2009 nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, pas propozimit të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së. Pagat e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të AAC-së janë caktuar nga Qeveria në përputhje me Nenin 20.2 të Ligjit për Aviacionin Civil.

4.1 BORDI MBIKËQYRËS i AAC-së

Në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil, veprimtaria e AAC-së mbikëqyrë nga Bordi Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga pesë anëtarë. Bordi vepron me orar jo të plotë dhe duhet të takohet së paku një herë për çdo tremujor kalendarik. Kryesuesi përfaqëson Bordin në publik dhe menaxhon e organizon punën e Bordit. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe ka kuorumin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nëse së paku tre anëtarë të Bordit janë të pranishëm.

Drejtori i përgjithshëm i AAC-së i dorëzon Bordit Mbikëqyrës raport gjithëpërfshirës të punës çdo tre muaj dhe raportin vjetor në fund të çdo viti kalendarik.

a) Mandati

Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës janë emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 5/98 të datës 29 qershor 2016 në këtë përbërje: z. Samet Dalipi, kryesues, z. Bekim Jashari, anëtar, z. Ardian Gaxherri, anëtar, dhe znj. Adelina Salihu, anëtare. Sipas Ligjit për Aviacionin Civil, mandati i anëtarëve të bordit është katërvjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat.

b) Kompetencat

Bordi Mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e (i) aktiviteteve dhe vendimeve të AAC-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore dhe të licencimit, dhe (ii) të gjitha aspekteve të menaxhimit financiar, të ardhurave dhe shpenzimeve të AAC-së. Sipas nenit 16.1 të Ligjit për Aviacionin Civil, nëse shumica e anëtarëve të Bordit konstatojnë se ka arsye për të besuar se AAC-ja nuk është përputhur ose nuk është duke u përputhur me një ose më shumë dispozita të këtij ligji ose një akti tjetër ligjor të zbatueshëm në Kosovë, Bordi duhet ta identifikojë (përcaktojë) fushën në të cilën dyshohet kjo mospërputhshmëri në një raport me shkrim, i cili më pas i dorëzohet Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit. Bordi nuk ka kompetenca ekzekutive, kompetenca të zbatimit ose kompetenca rregullative.

c) Funksionaliteti

Bordi Mbikëqyrës i AAC-së është funksional që nga muaji korrik i vitit 2016. Deri në fund të vitit 2016, Bordi ka mbajtur dy takime të rregullta dhe disa takime shtesë. Gjatë këtyre takimeve janë miratuar dy raporte tremujore të AAC-së.

4.2 EKZEKUTIVI

AAC-ja udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm i Aviacionit Civil, si organi më i lartë i drejtimit ekzekutiv dhe administrativ. Në punën e tij të përditshme ai mbështetet nga strukturat udhëheqëse të definuara më poshtë: Zëvendësdrejtori i përgjithshëm dhe menaxhmenti i mesëm.

a) Drejtori i përgjithshëm i AAC-së

Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në nenin 21 të Ligjit për Aviacionin Civil dhe në përputhje me ligjet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike, përfshirë këtu menaxhimin dhe raportimin e rregullt financiar. Ai punon me orar të plotë. Drejtori i përgjithshëm është zyrtar i AAC-së, i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC. Sipas nenit 26 të Ligjit për Aviacionin Civil, Drejtori i përgjithshëm përgjigjet para Kuvendit lidhur me përputhshmërinë e AAC-së me politikat e aviacionit civil si dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Z. Dritan Gjonbalaj është riemëruar Drejtor i përgjithshëm i AAC-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 nëntor 2013 përmes Vendimit nr. 8/157, pas propozimit të Ministrit të Infrastrukturës. Mandati i Drejtorit të përgjithshëm zgjat pesë (5) vjet. Sipas Ligjit për Aviacionin Civil, Drejtori i përgjithshëm mund të riemërohet nga Qeveria edhe për mandate të tjera pasuese me kohëzgjatje të njëjtë.

b) Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i AAC-së

Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil punon me orar të plotë. Zëvendësdrejtori ndihmon Drejtorin e përgjithshëm në udhëheqjen ekzekutive dhe administrative të AAC-së dhe, në mungesë të Drejtorit të përgjithshëm, kryen funksionet e tij. Gjatë vitit 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka bërë emërimin e Zëvendësdrejtorit të ri, pozitë e cila ka mbetur e lirë që nga marsi i vitit 2015.

c) Menaxhmenti i mesëm

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës, struktura udhëheqëse apo menaxhmenti i mesëm i AAC-së përbëhet nga drejtorët e departamenteve dhe drejtuesit/menaxherët e zyrave, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara në përshkrimet e punës. Drejtori i përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara në nenet 12.2 deri 18 të kësaj rregulloreje, të cilat dalin nga fushëveprimi i detyrave dhe kompetencave të AAC-së sipas ligjit. Përgjashtimisht, Drejtori i përgjithshëm mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e AAC-së një strukture apo punonjësi, jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture apo punonjësi, nëse ai e sheh të nevojshme. Drejtori i përgjithshëm gjatë mungesës së përkohshme, në pajtim me nenin 23.1 të LAC-it, delegon plotësisht apo pjesërisht kompetencat e tij dhe të AAC-së tek një punonjës me nivel përgjegjësie udhëheqëse.

Personat që përbëjnë strukturën udhëheqëse të AAC-së mbajnë akte emërimi me AAC-në me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

4.3 BURIMET NJERËZORE

AAC-ja ka 27 punëtorë, 26 prej tyre janë pozita të karrierës me akt emërimi, ndërsa një punëtor, të cilit i ka përfunduar angazhimi më 31 dhjetor 2016, ka qenë me kontratë të shërbimeve të veçanta. Gjatë vitit, dy zyrtarë kanë paraqitur dorëheqjen me vetëdëshirë. Ministria e Financave ka dhënë aprovim për rekrutim me qëllim plotësimin e këtyre pozitave si dhe të dy pozitave të reja, për të cilat AAC-ja ka bërë kërkesa të vazhdueshme.

Në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të AAC-së dhe sistematizimin e vendeve të punës janë paraparë 37 vende pune në AAC.

a) Trajnimet

AAC-ja investon në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të personelit të vet, në përputhje me standardet dhe praktikat e rekomanduara ndërkombëtare. Në bazë të një plani paraprakisht të miratuar trajnimesh, gjatë vitit 2016 personeli i AAC-së ka ndjekur trajnime të financuara nga donatorët si dhe trajnime të financuara nga buxheti i AAC-së. Personeli është trajnuar kryesisht në qendrën trajnuese të Autoriteteve të Përbashkëta të Aviacionit (JAA) në lidhje me sigurinë dhe operimet e fluturimeve dhe në qendrën trajnuese të Asociacionit Ndërkombëtar të Transportit Ajror (IATA). Shumica e trajnimeve janë ofruar në kuadër të projekteve të Komisionit Evropian: ISIS II, TAIEX dhe EASA IPA 3, siç është përshkruar në pikën 7.9(c) të këtij raporti. AAC-ja e Francës ka ftuar inspektorët e AAC-së që të ndjekin falas një numër trajnimesh profesionale të mbajtura në Shkollën Kombëtare të Aviacionit Civil në Tuluz të Francës.

Gjatë vitit 2016, personeli i AAC-së ka ndjekur gjithsej 75 trajnime, ku përfshihen edhe trajnimet e obliguara të inspektorëve të departamenteve profesionale në fushën e aviacionit civil. 60 prej këtyre trajnimeve janë ofruar falas nga projekti EASA-IPA 3 i KE-së, instrumenti për asistencë teknike TAIEX i KE-së, AAC-ja e Francës përmes Shkollës Kombëtare për Aviacion Civil, AAC-ja e Kroacisë, Instituti Kosovar për Administratë Publike, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave. Shih tabelën e trajnimeve të realizuara në vitin 2016 në Shtojcën 1 të këtij raporti.

4.4 ASETET

AAC-ja posedon 793 asete me vlerë në blerje prej 244,897.20 €. Vlerësimi dhe zhvlerësimi i aseteve bëhet çdo fundvit sipas dispozitave të Rregullores së Ministrisë së Financave nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Këto asete janë kryesisht orendi zyrrash, pajisje teknologjike dhe të ngjashme.

Sipas raportit të Komisionit për vlerësimin e pasurive, vlera e mbetur e aseteve të AAC-së pas zhvlerësimit është 5,027.4 €. Ndërsa vlera reale e këtyre aseteve, e vlerësuar nga Komisioni për vlerësimin e pasurisë është 42,405.75 €.

AAC-ja për vitin 2017 ka planifikuar blerjen e disa aseteve me vlerë të vogël për nevojat e stafit.

5. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS

Plani i punës për vitin 2016 është bazuar në planin strategjik të AAC-së për periudhën 2013-2018, duke i përcjell objektivat strategjike dhe duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore për përmbushjen e atyre strategjike.

Objektivat strategjike i shërbejnë AAC-së si bazë e mirë dhe e pazëvendësueshme për planifikimet vjetore që i bën organizata. Planet vjetore hartohen në nivel të menaxhmentit, pas një procesi të identifikimit të veprimeve në nivel të njësive organizative. AAC-ja vendos objektiva pune në baza vjetore. Këto objektiva planifikohen sipas konceptit S.M.A.R.T. (të thjeshta, të matshme, të arritshme, të arsyeshme, me afate kohore).

Gjatë muajit janar është konsoliduar plani për vitin 2016 dhe pastaj është miratuar nga Drejtori i përgjithshëm. Planin e punës në përmbajtje përfshin: planin e veprimit, planin e aktiviteteve mbikëqyrëse, planin e rekrutimit dhe planin e trajnimeve të personelit.

Në tremujorin e tretë të vitit ka ndryshuar versionin e planit të punës për të shtuar në plan edhe planin e menaxhimit të rreziqeve në AAC. Ky dokument është punuar nga menaxhmenti si kërkesë e standardit të ri të ISO-s 9001:2015, me të cilin AAC-ja e ka certifikuar sistemin e menaxhimit në nëntor të 2016-s, siç raportohet më poshtë.

Plani vjetor i punës është rishikuar çdo tre muaj dhe është raportuar zbatimin e veprimeve në baza tremujore nga menaxhmenti i AAC-së. Përveç rishikimeve tremujore, në AAC çdo vit bëhet edhe rishikimi vjetor i punës.

Plani i punës për vitin 2016 është realizuar 91%: plani i veprimit është realizuar në 84%, plani i trajnimeve 100% dhe plani i aktiviteteve mbikëqyrëse 90%.

Pasi që menaxhmenti ka analizuar realizimin e planit të punës, është konstatuar se disa nga veprimet që nuk janë realizuar gjatë vitit 2016 kanë qenë të ndërlidhura me aktivitetet e prokurimit, të cilat në shkurt të vitit 2016 kanë kaluar në përgjegjësi e Autoritetit Qendror të Prokurimit (AQP), dhe disa veprime nuk janë finalizuar për shkak të mungesës së buxhetit për aktivitetin e kontraktuar për përkthim të dokumenteve. Një numër veprimesh, si për shembull anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të aviacionit dhe hyrja në aranzhime kontraktuale ndërkombëtare, kanë qenë të varura nga rrethana politike dhe ligjore jashtë kompetencave vendimmarrëse të institucioneve të Republikës së Kosovës.


Plani i veprimit për vitin 2016 dhe realizimi i tij është i përfshirë në këtë raport në Shtojcën 2.

6. SISTEMI PËR MENAXHIM TË CILËSISË

a) Certifikimi i AAC-së me ISO 9001:2015 dhe auditimi i jashtëm

AAC-ja ka qenë e certifikuar për tre vite me radhë sipas Standardit ISO 9001:2008 për menaxhim të cilësisë. Ky certifikim ka skaduar në prill të vitit 2016 dhe gjithashtu standardi bazë ka ndryshuar versionin nga ISO 9001:2008 në Standardin ISO 9001:2015. AAC-ja ka marrë vendim për ri-certifikim të sistemit me standardin e ri 9001:2015 dhe ka filluar punët e përgatitjes për zbatim të ndryshimeve dhe risive qysh në fillim të vitit. Përmes Autoritetit Qendror të Prokurimit është përzgjedhur shtëpia e akredituar për certifikim me këtë standard, kompania TUV Austria, që të auditojë dhe certifikojë AAC-në sipas Standardit ISO 9001:2015.

Më 8 nëntor 2016, TUV Austria ka audituar Sistemin për Menaxhim të Cilësisë në AAC, të ngritur sipas standardit ISO 9001:2015. Auditimi ka rezultuar pa asnjë gjetje dhe si rezultat AAC-ja është certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015 deri në nëntor të vitit 2019. Kjo certifikatë dëshmon përputhshmëri të plotë të sistemit menaxhues në AAC me standardin për menaxhim të cilësisë. Për nivelin e mirëmbajtjes së këtij standardi, AAC-ja do të auditohet nga TUV Austria çdo vit gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.



Certifikata e lëshuar për AAC-në

b) Mirëmbajtja e Sistemit për Menaxhim të Cilësisë (SMC-së)

Për mirëmbajtjen e certifikatës, AAC-ja përcjell një varg kërkesash që rrjedhin nga ISO 9001:2015. Për të garantuar qëndrueshmërinë e sistemit të certifikuar, AAC-ja në baza vjetore duhet të auditojë sistemin e vet, të masë kënaqshmërinë e atyre që pranojnë shërbime nga ky autoritet, të rishikojë realizimin e punëve nëpër tremujorë dhe të rishikojë menaxhimin e punës në organizatë në përgjithësi. Për realizimin e këtyre obligimeve, AAC-ja gjatë vitit 2016 ka kryer veprimet që vijojnë:

- Është kryer auditimi i brendshëm në AAC me përfshirje të të gjitha njësive organizative. Auditimi njëjavor është realizuar nga ekipi prej katër auditorëve të brendshëm për SMC të AAC-së dhe ka rezultuar me rekomandime për përmirësim të proceseve dhe procedurave të punës brenda organizatës. Përmeshja e rekomandimeve përcillet përmes planit të veprimit.
- Gjatë gjysmëvjetorit të parë janë identifikuar dhe analizuar rreziqet që ndërlidhen me realizimin e pesë objektivave strategjike të AAC-së për periudhën 2013-2018. Janë përcaktuar edhe masat parandaluese apo përmirësuese në mënyrë që të konsiderohen të menaxhuara brenda organizatës. Kjo vjen si kërkesë nga ISO 9001:2015 dhe rekomandim nga raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015. Për analizimin e rreziqeve, AAC-ja është bazuar në Standardin ISO 31000:2009, Udhëzuesin ISO/IEC 73:2002, Manualin e ICAO-s për Menaxhimin e Sigurisë Doc. 9859 dhe Procedurën nr. 4 të Doracakut të Ministrisë së Financave "Menaxhimi financiar dhe kontrolli".
- Në dhjetor, për të pestën herë me radhë është realizuar matja e kënaqshmërisë së shfrytëzuesve të shërbimeve që ofron AAC-ja. Përmes një pyetësoi të shkurtër, është kërkuar mendimi i operatorëve të cilët i rregullon AAC-ja, që të vlerësojnë nivelin dhe cilësinë e dokumenteve që i harton AAC-ja, shërbimet gjatë certifikimeve dhe licencimeve të ndryshme, aktivitetete mbikëqyrëse që AAC-ja kryen te operatorët e aviacionit civil etj. Nga përgjigjet e pranuar është krijuar një mesatare e vlerësimit që arrin vlerën 4.44 në vitin 2016 (vlerat matëse nga 1 deri në 5). Në krahasim me vitin 2015 që ishte 4.38, këtë vit vlera mesatare e kënaqshmërisë tregon një rritje të lehtë. Çfarë është edhe më e rëndësishme, operatorët e intervistuar kanë dhënë edhe rekomandime për përmirësim, të cilat për AAC-në janë shumë të vlefshme dhe rishikohen nga menaxhmenti për t'i përdorur gjatë planifikimit të punëve. Përveç matjes së jashtme, AAC-ja ka realizuar edhe matjen e brendshme të kënaqshmërisë, e cila bëhet çdo vit me qëllim të marrjes së rekomandimeve për përmirësim nga vetë personeli i AAC-së. Grafiku me rezultatet e matjes është në Shtojcën 3 të këtij Raporti.
- Në janar të vitit 2017, menaxhmenti i AAC-së ka mbajtur takimin vjetor për rishikimin e menaxhimit gjatë vitit 2016. Ky takim është i përvitshëm, i planifikuar dhe përshkruar edhe në manualin e cilësisë dhe ka për qëllim rishikimin e mënyrës se si është menaxhuar organizata në vitin që përmbyllet dhe se cilat janë mundësitë për përmirësim në menaxhim.

7. PUNA GJATË VITIT PARAPRAK

7.1 PËRPPJEKJET PËR ANËTARËSIM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË TË AVIACIONIT

a) Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)

ICAO është agjenci e specializuar e OKB-së, e cila nxjerr standarde ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, të detyrueshme për 193 shtetet e saj anëtare. AAC-ja ka vazhduar punën përgatitore për anëtarësim në ICAO.

Më 8 shtator 2016, Drejtori i përgjithshëm i ka shkruar Ministrin të Punëve të Jashtme me kërkesë për të riaktualizuar çështjen e aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), duke përmblledh veprimet që janë marrë në këtë drejtim

nga paraardhësit e Ministrit Hoxhaj. Kërkesës i janë bashkëngjitur një pako dokumentesh relevante të hartuara nga AAC-ja që elaborojnë mundësitë e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në ICAO dhe përfitimet që do të sillte ky anëtarësim.

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për t'u faktorizuar në ICAO, Drejtori i përgjithshëm i ka shkruar zyrës regjionale për Evropë të ICAO-s në Paris në maj dhe shtator për të kërkuar këshillën e tyre mbi paraqitjen e kërkesës te Presidenti i Këshillit të ICAO-s që Kosova të marrë pjesë si vëzhguese në punimet e Asamblesë së 39-të të ICAO-s që do të mbahej në tetor. Nuk ka pasur përgjigje.

Më 10 tetor 2016, Drejtori i përgjithshëm i AAC-së ka uruar homologët e tij nga shtetet të cilat janë ri/zgjedhur anëtare në përbërjen e re të Këshillit të ICAO-s. Përbërja e Këshillit ndërrohet çdo 3 vjet, ndërsa Këshilli i ICAO-s është organ që menaxhon punët përmbajtësore të ICAO-s dhe ku çështja e ligjshmërisë së anëtarësimit të Kosovës do të mund të ngritej në rast të aplikimit. Nga 36 vendet anëtare të Këshillit, 20 apo 55.6% kanë njohur formalisht Kosovën, ndërsa për pesë të tjera AAC-ja ka vlerësuar se kanë qëndrim pozitiv ose neutral ndaj subjektivitetit juridik ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

Poashtu, më 24 nëntor 2016, Drejtori i përgjithshëm ka uruar z. Olumuyiwa Benard Aliu me rastin e rizgjedhjes së tij në pozitën e Presidentit të Këshillit të ICAO-s. Mandati i Presidentit të Këshillit të ICAO-s zgjat tre vjet me mundësi rizgjedhjeje.

Përderisa përpjekjet individuale për faktorizim në ICAO do të vazhdojnë, AAC-ja mbetet në pritje të vendimit të MPJ-së, e cila në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, do të përcaktojë kohën e duhur për aplikim në këtë organizatë.

b) ECAC dhe EUROCONTROL

Anëtarësimi në ICAO është parakusht që një shtet të konsiderohet për anëtarësim në organizatat panevropiane të aviacionit - Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC) dhe Organizatën Evropiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (EUROCONTROL). Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2016 nuk ka zhvillime sa i përket anëtarësimit në këto dy organizata. ECAC-u nxjerr politika ndërqeveritare për aviacionin civil në nivel evropian, ndërsa EUROCONTROL-i ndihmon në menaxhimin e hapësirës ajrore evropiane përmes krijimit të rregullave dhe ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, AAC-ja ka vazhduar përpjekjet që të marrë pjesë në punën e këtyre organizatave në cilësinë e vëzhguesit.

Më 6 shtator 2016, Drejtori i përgjithshëm ka përkujtuar zyrën e Drejtorit ekzekutiv të EUROCONTROL-it që AAC-ja e Kosovës është në pritje të përgjigjes mbi pranimin e saj dhe të ASHNA-s në cilësinë e vëzhguesit në takimet dhe punëtoritë teknike të kësaj organizate. AAC-ja kishte adresuar këtë kërkesë në maj të vitit 2015 dhe EUROCONTROL është përgjigjur se ende po merret me trajtimin e kësaj çështjeje.

c) EASA

AAC-ja ka vazhduar përpjekjet për të lidhur marrëveshje teknike të quajtura "Aranzhime të punës" me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (ang., European Aviation Safety Agency - EASA). EASA është agjenci e specializuar e BE-së, me përgjegjësi në fushën e sigurisë së aviacionit civil. Në këto përpjekje, AAC-ja ka pasur përkrahjen e vazhdueshme të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Integritimit Evropian. Më 20 qershor 2016, Drejtori i përgjithshëm është takuar me z. Patrick Ky, Drejtor ekzekutiv i EASA-s. Takimi i parë i këtij niveli është zhvilluar në zyrat qendrore të EASA-s në Këln të Gjermanisë. Qëllimi i takimit ishte shqyrtimi i kërkesës disavjeçare të AAC-së për të filluar negociimin e Aranzhimeve të punës midis AAC-së së Kosovës dhe EASA-s. Drejtori i përgjithshëm e ka informuar z. Ky për zhvillimet në fushën e sigurisë së aviacionit në Republikën e Kosovës dhe zbatimin e kuadrit ligjor të BE-së në këtë fushë, si detyrim i vendit tonë nga Marrëveshja për



Z. Gjonbalaj dhe z. Ky i EASA-s

Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Z. Ky falënderoi AAC-në për interesimin për të nënshkruar Aranzhime pune me EASA-n dhe konfirmoi se pas hyrjes në fuqi të MSA-së midis Kosovës dhe BE-së, nuk sheh më asnjë arsye për ta shtyrë më tej këtë çështje. Këto aranzhime do t'i mundësojnë AAC-së qasje në bazën evropiane të të dhënave të sigurisë së aeroplanëve, do të krijojnë kornizën e nevojshme për inspektim të performancës së AAC-së nga EASA si dhe për asistencë nga EASA në zbatimin e plotë të dispozitave përkatëse të Marrëveshjes HPEA. Deri më tani, EASA nuk ka hyrë në aranzhime kontraktuale me AAC-në për arsye të natyrës politike, jashtë fushëveprimit dhe mundësive të AAC-së apo institucioneve tjera të Republikës së Kosovës.

Nënshkrimi i Aranzhimeve të Punës me EASA-n pritet të bëhet gjatë vitit 2017 pas një vlerësimi faktmbledhës nga ana e EASA-s në Kosovë, të realizuar në nëntor 2016. Më shumë mbi këtë vlerësim mund të lexohet në pjesën 7.10(b).

7.2 NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE TË KOSOVËS

a) Përshkrimi i hapësirës ajrore të Kosovës

Hapësira ajrore e Kosovës që nga shtatori i vitit 1999 është pjesë e “Hapësirës së Përbashkët Operacionale të Ballkanit – JOA” të NATO-s, nën kontrollin operacional të Qendrës së Kontrollit të Operimeve të Kombinuara Ajrore 5 (Combined Air Operations Control 5 - CAOC5), e cila në vitin 2014 është transferuar te Qendra Torrejon e Operimeve të Kombinuara Ajrore (Combined Air Operation Centre Torrejon CAOC TJ). Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar, në të cilën ofrohen shërbime të trafikut ajror.

Në bazë të marrëveshjes në mes të NATO/KFOR-it dhe Hungarisë, hapësira e lartë ajrore e Kosovës (mbi nivelin e fluturimit 205) që nga prilli i viti 2014 për një periudhë pesëvjeçare do të menaxhohet nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë, HungaroControl, i cili bën kontrollimin e aeroplanëve që e mbikalojnë këtë hapësirë.

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës (nën nivelin e fluturimit 205) menaxhohet/kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, e cila ofron shërbime të navigacionit ajror për aeroplanët civilë gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterimit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës. Gjithashtu, shërbime ofrohen edhe për fluturimet e KFOR-it, EULEX-it dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të vendit. Hapësira e ulët ajrore është e klasifikuar si hapësirë e klasit D dhe F, në përputhje me dispozitat mbi klasifikimin e hapësirës ajrore nga Aneksi 11 i ICAO-s.

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur strukturat aktuale të hapësirës ajrore të Kosovës (hapësira e ulët dhe e lartë).

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës

Në hapësirën e ulët ajrore, aktualisht janë vetëm 2 korridore (shih figurën 1) që përdoren për trafik komercial për vajtje-ardhje nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Këto janë

XAXAN dhe SARAX në pjesën jugore të Kosovës në drejtim të Maqedonisë. Gjatë vitit 2016, në kuadër të takimeve për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (BANM), kanë vazhduar bisedimet për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore dhe hapjen e korridoreve ajrore me të gjitha shtetet fqinje të Kosovës. Këto takime pritet që të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2017. Më shumë detaje mbi këtë temë janë dhënë më poshtë.





Figura 1. Struktura e hapësirës së ulët ajrore në Republikën e Kosovës

Hapësira e lartë ajrore e Kosovës


Struktura e hapësirës së lartë ajrore përbëhet nga 2 sektorë (shih figurat 2 dhe 3) nga niveli i fluturimit FL205 (6 km) deri në FL285 (9 km) dhe nga niveli i fluturimit FL285 (9 km) deri në nivelin e fluturimit FL660 (20 km)



Sektori 1 (FL205 deri në FL285) përbëhet nga 4 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR.

Figura 2. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 1 (FL205 deri në FL285)



Sektori 2 (FL285 deri në FL660) përbëhet nga 5 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR;
5. Korridori UL603, i cili fillon nga pika hyrëse VABEK dhe përfundon në pikën dalëse OLOTA.

Figura 3. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 2 (FL285 deri në FL660)

b) Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës

Pas përfundimit të luftës, hapësira e lartë ajrore e Kosovës ka qenë e mbyllur për mbikalime të avionëve civilë, dhe nën autoritetin e NATO-s. Kjo hapësirë u hap për fluturime komerciale në vitin 2014, nën menaxhimin e HungaroControl-it. Kontrollorët tanë të trafikut ajror ofrojnë shërbime në hapësirën e ulët ajrore dhe menaxhojnë ngritjet dhe aterrimet në/nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, si dhe për fluturimet tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës (të shumtën helikopterë të KFOR-it).

Kontrolli i trafikut ajror në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës është nën mbikëqyrjen rregullatore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë, autoritetet e Republikës së Kosovës kanë punuar ngusht me NATO-n, KFOR-in, BE-në, ICAO-n dhe hisedarët tjerë në rajon për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit. Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të nismës së NATO-s: Mbledhja për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (*ang. Balkans Airspace Normalization Meeting – BANM*). Interesim të madh kanë pasur edhe kompanitë ajrore, sepse mbi Kosovë kalojnë disa rrugë që historikisht janë shfrytëzuar shumë në trafikun ajror ndërkombëtar. Meqë tanimë hapësira e lartë ajrore me rihapjen për fluturime komerciale në vitin 2014 konsiderohet e normalizuar, aktivitetet në kuadër të BANM-it janë të fokusuara në normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, që nënkupton para së gjithash hapjen e korridoreve të reja ajrore. Zhvillimet gjatë vitit 2016 janë përshkruar më poshtë.

Më 24 shkurt 2016, Ministrat z. Lutfi Zharku dhe znj. Edita Tahiri janë takuar në Prishtinë me përfaqësuesit e Stafit Ndërkombëtar të NATO-s rreth normalizimit të hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës. Takimi u mbajt me kërkesë të këtyre të fundit me qëllim të diskutimit me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth planit të NATO-s për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, dhe në këtë kontekst, marrjes së miratimit të Ministrave përgjegjës për fillimin e një serie të takimeve teknike midis Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës dhe Agjencisë së Shërbimeve të Trafikut Ajror të Serbisë dhe Malit të Zi, në Shtabin Qendror të NATO-s në Bruksel, të organizuara dhe lehtësuara nga Stafi Ndërkombëtar i NATO-s.

Më 14 dhjetor 2016, në Shtabin Qendror të NATO-s në Bruksel është mbajtur mbledhja e radhës për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit – BANM, organizuar nga stafi ndërkombëtar i NATO-s. Nga Republika e Kosovës në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës, Autoritetit të Aviacionit Civil, Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe atasheu i mbrojtjes i Republikës së Kosovës për Beneluks nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Bruksel. Në mbledhjen BANM, të udhëhequr nga Stafi Ndërkombëtar i NATO-s, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të autoriteteve aeronautike të shteteve të Ballkanit, organizatave relevante ndërkombëtare (ICAO, EUROCONTROL), Komisioni Evropian, IATA si dhe përfaqësues civilë dhe ushtarakë të misioneve të shteteve në NATO. Në këtë takim palët shprehën gatishmërinë në parim që të fillohet dialogu teknik midis ekspertëve, i lehtësuar nga NATO, për hapjen e korridoreve ajrore midis Kosovës dhe të gjitha shteteve fqinje, duke përfshirë edhe Serbinë.

Normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, ndër të tjera, nënkupton hapjen e korridoreve të reja ajrore midis Republikës së Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë, që do të shërbenin për të gjithë aeroplanët që fluturojnë në ANP “Adem Jashari”. Tash për tash, të gjitha fluturimet në Prishtinë kryhen vetëm përmes një korridori ajror që lidh Republikën e Kosovës me Maqedoninë. Korridoret e reja do ta shkurtonin kohën e fluturimit për rreth 15-20 minuta, do ta ulnin koston e operimit për kompanitë ajrore, që rrjedhimisht, do të duhej të reflektohej në bileta më të lira për udhëtarët tanë. Ky normalizim do të mundësojë edhe mbikalimin transit nëpër hapësirën tonë të ulët ajrore të shumë aeroplanëve që fluturojnë në aeroportet tjera të rajonit (p.sh. Tiranë, Podgoricë, Shkup, Selanik, Nish). Nga kjo do të ketë përfitime të ndjeshme financiare për Agjencinë tonë të Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Përveç kësaj, normalizimi do ta stimulojë zhvillimin e aviacionit të përgjithshëm në vendin tonë dhe shfrytëzimin pa kufizime të Aeroportit të Gjakovës, mes tjerash, edhe për shkollat e fluturimit.

7.3 MARRËVESHJA MBI HAPËSIRËN E PËRBASHKËT EVROPIANE TË AVIACIONIT (MARRËVESHJA HPEA)

Marrëveshja HPEA (ang. *European Common Aviation Area*; shq. *Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit*) është një marrëveshje multilaterale e cila krijon treg unik dhe rregulla të përbashkëta në fushën e aviacionit, e nënshkruar në mes të qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian, Islandës, Norvegjisë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. UNMIK-u e ka nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të Kosovës dhe e ka deklaruar atë perkohësisht të aplikueshme më 10 tetor 2006. Republika e Kosovës, përmes Deklaratës së Pavarësisë, përveç tjerash, ka marrë përsipër të gjitha detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të nënshkruara në emrin e saj nga UNMIK-u. Këto detyrime përfshijnë edhe zbatimin e Marrëveshjes HPEA. Zbatimi i Marrëveshjes HPEA në Republikën e Kosovës është bërë i detyrueshëm përmes Ligjit për Aviacionin Civil dhe rishtazi përmes Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Marrëveshja HPEA ende nuk është në fuqi dhe po zbatohet në nivel administrativ. Sipas njoftimit të fundit jozyrtar të Komisionit Evropian, të gjitha shtetet anëtare të BE-së tanimë e kanë ratifikuar Marrëveshjen, por Këshilli i BE-së ende nuk i ka përfunduar procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të saj. AAC-ja, si pikë kontakti për Marrëveshjen, përcjell zbatimin e saj nga institucionet e Kosovës. AAC-ja monitoron rregullisht legjislacionin e ndërlidhur me aviacion që nxjerr BE-ja, i informon sipas nevojës autoritetet tjera aeronautike të vendit rreth akteve të reja normative të BE-së dhe përfshin në planin e vet të veprimit secilin akt, përveç akteve të detyrueshme, edhe secilin akt tjetër që e konsideron të nevojshëm dhe të aplikueshëm. Legjislacioni i BE-së, i planifikuar për transponim në vitin 2017, është përfshirë në Planin Kombëtar për Zbatim të MSA-së.

Takimi i nëntë i Komitetit të Përbashkët i Marrëveshjes HPEA

Më 28 janar 2016 në Prishtinë, i organizuar nga AAC-ja, është mbajtur takimi i nëntë i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Në takim morën pjesë palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje: Komisioni Evropian, përfaqësues të shteteve të Ballkanit Perëndimor si dhe përfaqësues nga gjashtë shtete anëtare të BE-së dhe Norvegjia. Pjesëmarrës kishte edhe nga industria e aviacionit.



Pamje nga takimi i Komitetit të Përbashkët i Marrëveshjes HPEA në Prishtinë

Komiteti i Përbashkët është organi më i lartë mbikëqyrës i Marrëveshjes HPEA dhe në takimet e këtij organi diskutohen përparimet dhe sfidat në zbatimin e saj.

Komiteti i Përbashkët ka diskutuar çështjet e ngritura nga palët e Marrëveshjes dhe industria në mes të dy takimeve. Komisioni Evropian ka ngritur me shqetësim çështjen e ndalesës nga autoritetet serbe për mbikalimin e hapësirës ajrore të Serbisë të gjitha kompanive ajrore që e kanë nisje ose destinacion Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Ky problem është raportuar edhe më parë nga autoritetet e Republikës së Kosovës dhe kompanitë e ndryshme ajrore. Çështja e dytë e ngritur nga Kosova kishte të bënte me konkurrencën e padrejtë midis aeroportit të Shkupit dhe Prishtinës, të nxitur nga ndihma shtetërore që i ka dhënë dhe po i jep në vazhdimësi shteti i Maqedonisë një kompanie ajrore evropiane që operon në Shkup. Palët kanë qenë të interesuara edhe për çështje të ndryshme ligjore sa i përket ratifikimit dhe mënyrës së zbatimit të Marrëveshjes HPEA.

Vizita vlerësuese e Komisionit Evropian mbi zbatimin e Marrëveshjes HPEA nga autoritetet e Kosovës

Më 26-27 janar 2016, një ekip ekspertësh të KE-së ka qëndruar për një vizitë vlerësuese të nivelit të zbatimit të Marrëveshjes HPEA në Republikën e Kosovës.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, ekspertët kanë biseduar me zyrtarë të autoriteteve aeronautike të Kosovës (AAC-së, Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike) si dhe me zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me disa dispozita të Ligjit të Punës dhe me ata të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës lidhur me mbrojtjen e konkurrencës dhe ndihmën shtetërore në Kosovë. Në AAC, ekspertët përkatës kanë vlerësuar transponimin e legjislacionit për sigurinë e fluturimeve, atë të menaxhimit të trafikut ajror dhe të rregullimit ekonomik.

Më 21 shtator, AAC-ja ka pranuar nga Drejtoria për Transport dhe Mobilitet e Komisionit Evropian (DG MOVE) raportin final të ekspertëve mbi nivelin e zbatimit të Marrëveshjes HPEA në Kosovë. Raporti konfirmon progresin e konsiderueshëm në zbatimin e kërkesave të Marrëveshjes, jo vetëm për sa i përket fazës së parë tranzitore, por edhe të së dytës. Në bazë të raportit, kërkesat përkatëse të fazës së parë tranzitore janë në përputhje të plotë në të gjitha fushat e aviacionit, me përjashtim të dy çështjeve të mbetura në fushën e rregullimit ekonomik. Këto kanë të bëjnë me transponimin e disa dispozitave të Direktivës për orarin e punës, që përcaktojnë të drejtat themelore të punëtorëve, si dhe në fushën e mbrojtjes së konsumatorit në lidhje me zbatimin e dispozitave të të drejtave të udhëtarëve.

Shërbimet e Komisionit Evropian duhet të njoftohen posa të mbyllen dy gjetjet që janë theksuar në raport: njëra i takon Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa tjetra Ministrisë së Infrastrukturës. Përmbyllja e këtyre dy gjetjeve i mundëson Kosovës kalimin në fazën e dytë, më të avancuar të zbatimit të marrëveshjes.

7.4 PROGRAMI SHTETËROR I SIGURISË (PSHS)

Sipas Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (LAC), AAC-ja, si autoritet me përgjegjësi në sigurinë e aviacionit civil, duhet të iniciojë dhe koordinojë hartimin dhe zbatimin e Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS) së aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Hartimi dhe zbatimi i PSHS-së është edhe njëra ndër objektivat strategjike të AAC-së për periudhën 2013-2018.

Ky është një program i përbashkët i të gjitha institucioneve me rol në sigurinë dhe politikat e aviacionit civil, siç janë përcaktuar me LAC, në të cilin përshkruhet sistemi shtetëror për rregullim dhe menaxhim të sigurisë në aviacionin civil.

Standardet për hartimin e këtij programi janë të caktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), përmes Aneksit 19 "Menaxhimi i Sigurisë" të Konventës së Çikagos. Ky Aneks ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2013 dhe shtetet ratifikuese të Konventës kanë detyrim zbatimin e plotë të tij në planet afatmesme të punës. Republika e Kosovës ende nuk e ka ratifikuar këtë Konventë, mirëpo përmes Ligjit për Aviacionin Civil ka marrë obligim për zbatimin e të gjitha standardeve të ICAO-s.

Për të përmbushur kërkesat e PSHS-së, gjatë vitit 2016 janë ndërmarrë veprimet e përshkurara më poshtë.



Me inicimin e AAC-së si organizatë përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës dhe propozimin e Ministrit të Infrastrukturës, përmes Vendimit nr. 05/96, dt. 26 qershor 2016, Qeveria ka emëruar Drejtorin e përgjithshëm të AAC-së në cilësinë e Zyrtarit përgjegjës për PSHS në Republikën e Kosovës dhe ka themeluar Komitetin e PSHS-së me këtë përmbajtje: Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil – udhëheqës, Drejtori i Departamentit të Aviacionit Civil në Ministrinë e Infrastrukturës – anëtar, Kryesuesi i Komisionit për Hetim të Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike – anëtar, Kryeshefi i Agjencisë për Menaxhim Emergjent – anëtar, Drejtori i Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror – anëtar.

Takimi i parë i komitetit të PSHS-së është mbajtur më 8 korrik, në të cilin është vendosur të hartohen Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit dhe që në nivel pune të caktohen zyrtarë nga të gjitha institucionet për të vazhduar koordinimin dhe punën sipas kërkesave të PSHS-së. Në vazhdim është kryer koordinimi

për hartimin e legjislacionit të nevojshëm për transponimin e Aneksëve të ICAO-s, për të cilat këto institucione janë përgjegjëse sipas Ligjit për Aviacionin Civil.

Më 20 tetor 2016 është miratuar Manuali i Programit Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Përmes këtij Manuali, Kosova e paraqet situatën sa i përket përmbushjes së kërkesave të PSHS-së dhe e tregon mënyrën e menaxhimit të sigurisë së aviacionit civil në vend. AAC-ja ka iniciuar dhe hartuar Manualin në konsultim me anëtarët e Komitetit të PSHS-së. Manuali është nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm i AAC-së në cilësinë e Zyrtarit përgjegjës për PSHS.

Dokumentet e analizës GAP (në shqip analiza e hendeqeve) për PSHS-në janë përditësuar për të dhënë informatat e fundit në përmbushjen e detyrave drejt realizimit të PSHS-së. Analiza GAP dhe Plani i veprimit tani kanë versionin numër 4.

Më 10 nëntor 2016, Drejtori i përgjithshëm ka miratuar Manualin e detyrimit për zbatim të rregulloreve të sigurisë në aviacionin civil. Ky manual duhet i shërben personelit mbikëqyrës në AAC, pasi që definon proceset e punës për zbatim të rregulloreve nga industria që rregullon AAC-ja. Manuali e përkrah qasjen bashkëpunuese që AAC-ja synon ta ketë me operatorët, me ç'rast zbatimi i rregulloreve bëhet në mënyrë të vullnetshme dhe proaktive nga ana e tyre. Përveç proceseve bashkëpunuese, manuali përshkruan edhe proceset e reagimit në rast se operatorët dështojnë apo vonojnë zbatimin e standardeve të sigurisë.

7.5 AUDITIMI VLERËSUES I AEROPORTIT TË GJAKOVËS

Aeroporti i Gjakovës, i cili ndodhet rreth 5 km në veri të këtij qyteti, është rindërtuar nga kontigjenti italian i KFOR-it me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve ushtarake për fluturaket e misionit të NATO-s në vendin tonë. Në fund të dhjetorit 2013 është nënshkruar një marrëveshje në mes të Qeverisë Italiane dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila mundësoi transferimin e Aeroportit të Gjakovës te autoritetet e Kosovës, përfshirë edhe të gjitha pajisjet për operime. Në mars të vitit 2015, Qeveria e Kosovës mori vendim për themelimin e Ndërmarrjes Publike Qendrore "Aeroporti i Gjakovës" dhe më vonë ka emëruar strukturat udhëheqëse të saj.

Me kërkesë të menaxhmentit të Aeroportit të Gjakovës, AAC-ja ka kryer një auditim gjithëpërfshirës në Aeroportin e Gjakovës, prej 25 deri 29 prill 2016, për të vlerësuar infrastrukturën dhe pajisjet ekzistuese: infrastrukturën e fushës ajrore (pistën, rrugën e taksimit së bashku me shenjëzimet përkatëse, ndriçimin etj), pajisjet e navigimit, infrastrukturën e shërbimit zjarrfikës dhe furnizimit

me karburante, infrastrukturën për procesimin dhe transportin e udhëtarëve dhe mallrave në/nga aeroporti, etj.

Gjatë procesit të auditimit është analizuar dhe konsultuar i gjithë dokumentacioni dhe informatat në lidhje me Aeroportin e Gjakovës si dhe janë përpiluar listat kontrolluese me referencë nga legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Plani dhe fushëveprimi i auditimit është krijuar dhe përshtatur në atë mënyrë që të përmbushë qëllimin e auditimit.

Pas përfundimit të auditimit njëjavor, departamentet përgjegjëse (Aerodromet dhe SHNA) kanë përgatitur dhe publikuar raportin i cili reflekton gjendjen e këtij aeroporti. Raporti në gjuhën shqipe dhe angleze është dorëzuar te menaxhmenti i aeroportit si dhe te institucionet e tjera relevante shtetërore. Sipas raportit, aeroporti ka një sistem të vetëm piste me një rrugë paralele për taksim. Pista është 1,799 metra e gjatë, 30 metra e gjerë dhe e orientuar në drejtimet 17-35. Sipërfaqja e pistës është asfalt, anët e pistës janë të gjëra 7.5 metra, të shtruara me zhavor. Hapësira e terminalit të aeroportit përbëhet nga hapësirat e terminalit të udhëtarëve dhe mallrave, parkingu i aeroplanëve, hapësirat për ngarkimin, shkarkimin dhe hapësirat për shërbime të udhëtarëve. Aeroporti ka edhe infrastrukturën e furnizimit me rrymë dhe ujë. Rrjeti i shpërndarjes së ujit për ndërtesat e ndryshme si terminali i udhëtarëve, ndërtesa e mallrave, hangari etj., bëhet përmes rrjetit kryesor të qytetit si dhe sistemit rezervë. Për furnizimin alternativ, në dispozicion është një rrjet i ndarë furnizimi me ujë (nënstacion i ujit), me kapacitet 20.000 litra. Furnizimi me rrymë për terminal dhe ndërtesat e administratës bëhet përmes dy burimeve, nga nënstacioni i rrjetit kryesor dhe nga sistemi dytësor si alternativë e rrjetit kryesor të furnizimit. Sistemi alternativ përbëhet nga 4 gjeneratorë me kapacitet 1100 kVA. Sistemi i ndriçimit aeronautik në tokë dhe i ndihmesave vizuale dhe atyre të radio navigimit furnizohet me energji elektrike nga rrjeti kryesor i qytetit dhe nga sistemi i gjeneratorëve brenda aeroportit. Poashtu, në këtë aeroport ekziston edhe infrastruktura dhe mjetet për shërbimin e shpëtimit, zjarrfikjes dhe për furnizimin me karburante të aeroplanëve.



Ekipi auditues i AAC-së dhe stafi i Aeroportit të Gjakovës

Inspektimi i infrastrukturës në dispozicion për ofrimin potencial të shërbimit të kontrollit të trafikut ajror dhe pajisjeve ekzistuese të navigacionit, komunikimit dhe të shërbimit meteorologjik ka treguar që në Aeroportin e Gjakovës është e instaluar një kullë mobile e kontrollit të trafikut ajror, plotësisht e pajisur me sistemet e nevojshme të komunikimit tokë-ajër dhe pozita punuese. Aeroporti i Gjakovës ka në dispozicion sistemin për aterrim instrumental dhe sistemin navigues NDB (Non-directional Beacon) që përdoret si ndihmë për navigim nga ana e pilotëve. Aeroporti është i pajisur edhe me një

varg pajisjesh meteorologjike për matjen e shtypjes, temperaturës, drejtimit dhe shpejtësisë së erës, lagështisë dhe lartësisë së reve.

Ekipi auditues i AAC-së ka vërejtur me kënaqësi që, ndonëse aeroporti ka qenë jashtë funksionimit për dy vite me radhë, stafi i Aeroportit me një përkushtim të veçantë ishte përkujdesur për ruajtjen e sistemeve dhe dokumentacionit përcjellës. Aktualisht, aeroporti është i mbyllur për operime.

7.6 ÇËSHTJET E AVIACIONIT TË NDËRLIDHURA ME INTEGRIMIN EVROPIAN

a) Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

Më 27 tetor 2015 është nënshkruar Marrëveshja për Stabilizim-Asociim (MSA) midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Marrëveshja parasheh obligime edhe në transportin ajror, duke e bërë Marrëveshjen HPEA pjesë integrale të saj. Udhëhequr nga Ministria për Integritet Evropian (MIE), institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë AAC-në, japin input në hartim dhe pastaj zbatojnë në periudha vjetore Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) që del nga obligimet e marra përsipër përmes kësaj Marrëveshjeje dhe procesi i avancimit të integritetit evropian.

Në zbatim të këtij plani, AAC-ja ka realizuar tri masa legislative dhe një masë zbatuese gjatë vitit raportues. Ndërsa 17 masa legislative janë planifikuar që të kryhen gjatë vitit 2017, prej të cilave 8 janë masa plotësisht të reja.

b) Raporti i Vendit për Kosovën i Komisionit Evropian

Më 9 nëntor 2016, Komisioni Evropian ka publikuar Raportin e Vendit për Kosovën. Sa i përket aviacionit, në këtë Raport thuhet se Kosova ka bërë progres thelbësor në përafrimin me *Acquis* të BE-së dhe ka zbatuar pothuajse të gjitha kërkesat nga faza e parë kalimtare e Marrëveshjes HPEA, me përjashtim të pak dispozitave në fushën e rregullimit ekonomik. Për legjislacionin e 'Qiellit të Vetëm Evropian' (SES), thuhet se Kosova ka përfunduar harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit SES I dhe ka bërë përparim në SES II. Ndërsa, përmendet se ende nuk janë lidhur Aranzhimet e punës me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit.

Raporti më tej shton se ka pasur ca progres në zbatimin e Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Megjithatë, legjislacioni zbatues ende duhet të përfundohet duke përfshirë kriteret për pozitat drejtuese. Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror është certifikuar, përfundon Raporti sa i përket aviacionit.

c) Takimi sektorial dhe plenar i transportit në kuadër të DPSA-së

Më 15 janar 2016, AAC-ja ka dhënë kontributin e saj me shkrim në raportin që MIE i ka dërguar KE-së në parapërgatitje të takimit sektorial të Komisionit për Mjedis, Transport, Energji dhe Zhvillim Rajonal në kuadër të Dialogut për Procesin e Stabilizim-Asociimit (DPSA), të mbajtur më 25 shkurt 2016 në Bruksel. Në përgjigje të kërkesës së KE-së, AAC-ja ka raportuar në lidhje me certifikimin e ASHNA-s, zhvillimet në zbatimin e HPEA-së, bashkëpunimin ndërkombëtar që ka përfshirë Iniciativën JSPA, bashkëpunimin me Shqipërinë dhe Projektin EASA-IPA 3, dhe certifikimin e operatorëve ajrorë.

Ky raportim është plotësuar verbalisht gjatë takimit të 25 shkurtit për të raportuar transponimin e Rregullores (KE) nr. 1070/2009, veprim i dalë në takimin e kaluar të DPSA-së. të mbajtur në maj të 2015-s, dhe Rregullores (KE) nr. 1794/2006. Në draft-raportin e dalë nga takimi, si veprime të mbetura përmenden "përmbushja e disa kërkesave të mbetura nga Faza I e HPEA-së, siç është Direktiva mbi orarin e punës" dhe "zbatimi i Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajrore, duke u fokusuar në punësimin e personelit dhe burimet kyçe", të dyja çështje që nuk janë në fushëveprimin e AAC-së.

Më 27 dhjetor 2016, AAC-ja ka raportuar në MIE në përgatitje për takimin e Nënkomitetit të MSA-së për transport, mjedis, energji dhe zhvillim rajonal, që mbahet në shkurt të vitit 2017 në Prishtinë.

7.7 REAGIMINDAJ NDIHMËS SHTETËRORE TË MAQEDONISË OFRUAR KOMPANIVE AJRORE

Në vitin 2012, Republika e Maqedonisë ka vendosur një skemë financiare trevjeçare të nxitjes për operime për një kompani ajrore me tarifa të ulëta. Kjo skemë u vazhdua më 2014 edhe për periudhën 2015-2018. Pasi që subvencionet e Qeverisë së Maqedonisë për fituesin e këtij tenderi mund të përbënin shkelje të rregullave të BE-së në fushën e konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, duke marrë parasysh ndikimin negativ që këto subvencione mund të kishin në operimet e ANP “Adem Jashari”, AAC-ja dhe MI-ja kanë adresuar këtë çështje në nivele të ndryshme, direkt me Maqedoninë si dhe me Komisionin Evropian. Siç është raportuar më lart në pikën 7.3, kjo ishte temë diskutimi edhe në takimin e nëntë të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes HPEA të mbajtur më 28 janar 2016 në Prishtinë. Megjithatë, autoritetet e Kosovës nuk kanë marrë asnjëherë ndonjë vendim nga KE-ja mbi shqetësimin e ngritur.

Më 13 korrik 2016, Drejtori i përgjithshëm i ka dërguar Komisionit Evropian një studim ligjor, të përpiluar nga AAC-ja, ku më tutje ndërtohet dhe përditësohet rasti që elaboron ndihmën shtetërore të dhënë nga Qeveria e Maqedonisë dhe se si kjo ndikon në konkurrencën e padrejtë ndaj ANP “Adem Jashari”.

Më 21 shtator është përgjigjur z. Carlos Bermejo Acosta, Udhëheqës i njesisë për çështje të aviacionit dhe transportit ndërkombëtar në KE, i cili thotë se ka udhëzuar shërbimet e tij për të proceduar këtë informacion në konsultim me departamentet përgjegjëse të Komisionit. Informacioni është me të vërtetë i vlefshëm për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje, thuhet në letrën e z. Acosta. “Ju lutem të jeni të sigurt se Komisioni do të bëjë çmos për të parandaluar ndonjë çrregullim të konkurrencës në Hapësirën e Përbashkët të Aviacionit dhe për të siguruar përputhje me dispozitat e aplikueshme të së drejtës së BE-së”, përfundon ai. Deri në mbylljen e vitit, AAC-ja nuk ka pranuar ndonjë konkluzion nga ky shqyrtim i KE-së.

Në Raportin e Vendit për Maqedoninë për vitin 2016, Komisioni Evropian thekson se “shqetësimet rreth ndihmës së mundshme shtetërore në sektorin e aviacionit duhet të adresohen.”

7.8 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

AAC-ja ka bashkëpunuar ngusht me institucionet tjera përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Poashtu, sipas nevojës, është ofruar përkrahje profesionale në fushën e aviacionit civil për institucionet tjera të shtetit.

a) Bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar për ZHEITI

Më 25 tetor 2016, Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri vizitoi Autoritetin e Aviacionit Civil, në kuadër të aktiviteteve të veta të mbikëqyrjes së agjencive të pavarura që i raportojnë Kuvendit.

Komisioni u prit nga Bordi Mbikëqyrës i AAC-së, i kryesuar nga z. Samet Dalipi, si dhe nga menaxhmenti i AAC-së, i kryesuar nga Drejtori i përgjithshëm. Kryesuesi i Bordit dhe Drejtori i përgjithshëm i AAC-së e informuan Komisionin për aktivitetet e AAC-së gjatë këtij viti, të arriturat në aspektin e zbatimit të legjislacionit të BE-së, por edhe për sfidat me të cilat po ballafaqohet AAC-ja.

Gjatë takimit Kryetari i Komisionit, z. Muhamet Mustafa, përgëzoi AAC-në për punën e deritashme dhe konfirmoi zotimin e Komisionit për të ofruar përkrahje edhe në realizimin e disa prej synimeve



Pamje nga vizita e Komisionit Parlamentar për ZHEITI

strategjike, siç është anëtarësimi në ICAO dhe në përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së. Gjatë takimit u diskutua edhe për çështje të tjera me rëndësi në fushëveprimin e AAC-së.

b) Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës

Ashtu siç parashikohet me Ligjin për Aviacionin Civil, AAC-ja ka këshilluar Ministrin e Infrastrukturës dhe Departamentin e Aviacionit Civil në këtë Ministri në realizimin e përgjegjësi që dalin nga ligji.

AAC-ja është pjesë e grupit punues për Strategjinë Kombëtare të Aviacionit Civil, të emëruar nga Ministri i MI-së, dhe në këtë cilësi i ka dhënë mbështetje MI-së dhe ka kontribuar në punën e grupit.

AAC-ja poashtu ka mbështetur MI-në në analizimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis MI-së dhe Ministrisë homologe të Hungarisë mbi shërbimet ajrore Budapest-Prishtinë.

c) Bashkëpunimi me Ministren për Dialog

Edhe gjatë vitit 2016, AAC-ja ka vazhduar përkrahjen profesionale sa herë që ka qenë e nevojshme në kuadër të aktiviteteve për normalizimin e hapësirës ajrore të Kosovës dhe përgatitjen e dokumenteve strategjike për dialogun eventual me Serbinë në fushën e transportit ajror, të lehtësuar nga BE-ja.

Me kërkesë të Ministres për Dialog, më 18 janar 2016, Drejtori i përgjithshëm ka marrë pjesë në delegacionin e Republikës së Kosovës, të udhëhequr nga Ministrija Tahiri, në një takim informues me NATO-n dhe BE-në në lidhje me temat e pritshme të dialogut për normalizimin e raporteve me Serbinë në fushën e aviacionit civil.

AAC-ja ka hartuar një koncept-dokument për Ministrat z. Lutfi Zharku dhe znj. Edita Tahiri para takimit të tyre me përfaqësuesit e Stafit Ndërkombëtar të NATO-s, më 24 shkurt 2016 në Prishtinë, rreth normalizimit të hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës. Takimi u mbajt me kërkesë të këtyre të fundit me qëllim të diskutimit me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth planit të NATO-s për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, dhe në këtë kontekst, marrjes së miratimit të Ministrave përgjegjës për fillimin e një serie të takimeve teknike midis Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës dhe Agjencisë së Shërbimeve të Trafikut Ajror të Serbisë dhe Malit të Zi, dhe lehtësuara nga Stafi Ndërkombëtar i NATO-s. Ende nuk është zhvilluar asnjë takim me palën serbe.

d) Bashkëpunimi me KFOR-in

Një bashkëpunim shumë i ngushtë ka vazhduar me njësinë ajrore të KFOR-it (J3 Air), sidomos në lidhje me normalizimin e hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, për të cilën KFOR-i ka përgjegjësi të rëndësishme, si dhe aprovimin e fluturimeve të aviacionit të përgjithshëm dhe koordinimin e aktiviteteve që ndërlidhen me operimin e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (dronëve).

e) Bashkëpunimi me KHAIA

AAC-ja i ka ofruar asistencë profesionale Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA) pranë Zyrës së Kryeministrit lidhur me hetimin e aksidentit të kompanisë ajrore "Turkish Airlines" të datës 2 maj 2016, në Prishtinë.

f) Bashkëpunimi me organizatat aeronautike në Kosovë

Gjatë vitit 2016, AAC-ja ka mbajtur një numër të takimeve të përbashkëta me Federatën Aeronautike të Kosovës. Këto takime kanë pasur për qëllim bashkërendimin e aktiviteteve të cilat ndërlidhen me zhvillimin e aviacionit të përgjithshëm, licencimin e pilotëve të rinj sportivë, si dhe mundësinë e shfrytëzimit të fushave ajrore sportive në territorin e vendit tonë, me theks të veçantë në mundësinë e shfrytëzimit të aeroportit sportiv të Batllavës në Dumosh.

Inspektorë të AAC-së poashtu kanë bashkëpunuar ngushtë me organizatën trajnuese për paragllajdzëm, Kosovo Fly Academy (KFA), si gjatë procesit për certifikimin e tyre, ashtu edhe gjatë fazës përgatitore që KFA kishte ndërmarrë për ndërtimin e një piste dhe objekteve tjera përcjellëse në komunën e Istogut.

g) Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës

Janë organizuar një sërë takimesh me zyrtarët e Policisë së Kosovës (PK) lidhur me strategjinë në nivel të vendit sa i përket raportimit dhe procedurave të reagimit ndaj rasteve të ndriçimit të mjeteve ajrore me dritë laserike në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Në këto takime është punuar rreth avancimit të "Marrëveshjes së mirëkuptimit për bashkëpunim reciprok", të nënshkruar ndërmjet AAC-së, PK-së dhe ASHNA-së. Më 13 qershor 2016, në shkollën "Xhavit Ahmeti" në qytetin e Gjilanit, inspektori i operimeve ajrore në AAC, në bashkëpunim me njësitin e KFOR-it dhe Policinë e Kosovës, ka marrë pjesë në fushatën vetëdijësuese "Drejtimi i laserëve ndaj mjeteve ajrore". Për më tepër, zyrtarët e AAC-së dhe ata të Policisë së Kosovës kanë organizuar katër takime të përbashkëta në lidhje me personat të cilët operojnë me sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (dronët). Në këto takime janë harmonizuar procedurat e dhënies së lejeve për operatorët e dronëve nga AAC-ja si dhe ato të reagimit dhe masave ndëshkuese në rastet e shkeljeve ligjore nga operatorët.

h) Bashkëpunimi me Zyren e Rregullatorit të Energjisë

Më 3 nëntor 2016, Drejtori i përgjithshëm i AAC-së, z. Dritan Gjonbalaj, dhe z. Krenar Bujupi, u.d. Kryetar i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi në mes të dy rregullatorëve. Qëllimi i këtij Memorandumi është shkëmbimi i përvojave të stafit teknik në fushën e rregullimit ekonomik.



Pamje nga ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit

7.9 AKTIVITETI I AAC-SË NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR

AAC-ja ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha iniciativat rajonale të aviacionit civil. Këto forume kanë një rëndësi të veçantë për vendin tonë, duke e ditur se Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e barabartë e familjes ndërkombëtare të kombeve në fushën e aviacionit civil. Ne kemi shfrytëzuar çdo mundësi ta prezantojmë punën e autoriteteve tona dhe të thellojmë bashkëpunimin me AAC-të e shteteve tjera. Sidoqoftë, për shkak se vendi ynë ende nuk ka pasur mundësi të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me BE-në në fushën e aviacionit civil (p.sh. Aranzhimet e punës me EASA-n), ende ka pengesa serioze në trajtimin tonë si partner plotësisht i barabartë me AAC-të tjera të rajonit.

a) Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil

AAC-ja i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit me autoritetet homologe të rajonit, duke marrë parasysh se të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë duke kaluar nëpër të njëjtën sfidë – atë të harmonizimit të legjislacionit, rregullave e të standardeve në aviacionin civil me ato të BE-së. Për të formalizuar këtë bashkëpunim, janë nënshkruar një numër marrëveshesh bashkëpunimi teknik që nga themelimi i AAC-së në vitin 2009.

- Bashkëpunimi dypalësh me Shqipërinë

Në kuadër të marrëveshjes me Autoritetin e Aviacionit Civil të Shqipërisë (AACSH), është vazhduar bashkëpunimi dypalësh në mes të dy autoriteteve rregullatore.

Një delegacion i Drejtorisë së Sigurisë Ajrore të AACSH-së ka vizituar homologët e tyre në AACK më 12-15 prill 2016. Zyrtarët e dy Autoriteteve janë pajtuar që ky bashkëpunim të thellohet përmes auditimeve të përbashkëta të operatorëve, të licencimit të personelit si dhe shkëmbimit të materialeve udhëzuese dhe dokumentacionit tjetër teknik. Në këtë vazhdë, inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve (DSF) së bashku me inspektorët e AACSH-së kanë kryer dymbëdhjetë inspektime të përbashkëta të mjeteve të huaja ajrore në platformë (SAFA) në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Terezë” gjatë tetorit. Ky bashkëpunim ka mundësuar, përveç tjerash, shkëmbimin e përvojave dhe njohurive të ekspertëve, që do të ndihmojnë në ngritjen e vazhdueshme të nivelit të sigurisë dhe standardeve të aviacionit në të dy shtetet, si dhe proceseve të integritetit në organizmat ndërkombëtarë siç është EASA.



Inspektorët SAFA të Kosovës dhe Shqipërisë në Aeroportin “Nënë Tereza” të Tiranës

Në muajin dhjetor, stafi i Departamentit të Aerodromeve të AAC-së së Shqipërisë kanë qenë në Prishtinë për të diskutuar ndër të tjera për rrezikun e aeroplanit në fazën fillestare të nisjes nga bota shtazore. Për këtë qëllim është vizituar njësia për menaxhimin e botës shtazore në ANP "Adem Jashari" për t'i prezantuar masat praktike që operatori ndërmerr për t'i parandaluar këto rrezeqe.

Poashtu në dhjetor, katër zyrtarë të Drejtorisë së Zhvillimit të Transportit Ajror në AACSH kanë realizuar një vizitë pune në Prishtinë me qëllim shkëmbimin e përvojave me Departamentin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit në AAC-në e Kosovës në raportimin e statistikave të transportit ajror dhe monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes HPEA.

- **Bashkëpunimi dypalësh me Kroacinë**

Dy zyrtarë të AAC-së, përgjegjës për rregullimin ekonomik, dhe dy zyrtarë përgjegjës për financa dhe buxhet nga ASHNA, kanë vizituar Kroacinë në janar për t'u takuar me homologët e tyre nga AAC-ja e Kroacisë dhe Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Kroacisë "Croatia Control". Qëllimi i takimeve ka qenë trajnimi praktik në zbatimin e rregullores evropiane për përcaktimin e tarifës terminale të navigacionit, e cila ka filluar së zbatuari në Kosovë në fillim të vitit 2016, përderisa Kroacia ka një përvojë disaveqare në zbatimin e saj. Njohuritë e përfituara gjatë këtyre takimeve kanë qenë shumë të dobishme gjatë procesit të përcaktimit të tarifës njësi terminale në Republikën e Kosovës për vitin 2017, të cilën AAC-ja e ka ndërmarrë për herë të parë. Më gjërësisht mbi këtë proces mund të lexohet në seksionin 7.10 (d) të këtij Raporti.

- **Bashkëpunimi dypalësh me Francën**

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit Teknik, të nënshkruar më 20 shtator 2012 nga AAC-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil të Francës, gjatë vitit 2016 ka vazhduar bashkëpunimi teknik në mes të autoriteteve të dy vendeve, i cili ka pasur më shumë karakter të ngritjes së kapaciteteve profesionale të personelit të AAC-së dhe ASHNA-s. Inspektorë të AAC-së kanë përfituar falas pjesëmarrjen në 6 punëtori teknike, kryesisht nga lëmia e navigacionit ajror, të organizuara nga Shkolla Kombëtare e Aviacionit Civil - ENAC (Ecole Nationale de l'Aviation Civile) në Tuluz. Poashtu, në muajin qershor, një ekspert i shërbimeve të navigacionit ajror nga AAC-ja e Francës ka përkrahur inspektorët e AAC-së gjatë auditimit që ata i kanë bërë Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror, para se ta rekomandojnë certifikimin e saj.

b) Bashkëpunimi shumëpalësh rajonal

Bashkëpunimet shumëpalëshe rajonale në mes të autoriteteve aeronautike janë dëshmuar si vlerë e shtuar për shkak të përfitimeve të ndryshme nga shkëmbimi i eksperiencës dhe ekspertizës në të gjitha fushat e aviacionit civil. Përpos bashkëpunimit trepalësh me Shqipërinë e Maqedoninë, më poshtë janë përshkruar aktivitetet në kuadër të iniciativës rajonale JSPA.

- **Bashkëpunimi me Shqipërinë dhe Maqedoninë**

Më 22 nëntor 2016, Drejtori i përgjithshëm ka pritur në takim pune Drejtorin e ri të Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë, z. Flamur Çelaj, dhe Drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë së Aviacionit Civil të Maqedonisë, z. Goran Jandreoski. Z. Gjonbalaj ka uruar z. Çelaj për detyrën e re dhe ka ritheksuar zotimin e AAC-së për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit të shkëlqyer midis AACK-së dhe AACSH-së. Gjithashtu ka falënderuar z. Jandreoski për bashkëpunimin e mirë midis dy autoriteteve, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, të nënshkruar disa vjet më parë nga drejtorët e përgjithshëm të aviacionit civil të tre shteteve.

Të tre drejtorët janë pajtuar për një bashkëpunim edhe më intensiv dhe shkëmbim të përvojave në mes të stafit me qëllim të integrimit të plotë të vendeve tona në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

- **Iniciativa për krijimin e Zonës së Përbashkët për Ofrimin e Shërbimeve**

Iniciativa për krijimin e Zonës së Përbashkët për Ofrimin e Shërbimeve (JSPA) është një projekt rajonal që ka filluar në vitin 2013. Kjo nismë ka për qëllim krijimin e kushteve për bashkëpunim më të thellë mes AAC-ve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror të rajonit, sidomos në zbatimin e kërkesave që dalin nga krijimi i Qiellit të Vetëm Evropian.

Gjatë vitit 2016 janë realizuar dy aktivitete në kuadër të grupit përgatitor të iniciativës JSPA:

- Më 10 maj, në Budapest të Hungarisë, është mbajtur takimi i radhës i grupit përgatitor të Iniciativës JSPA. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e sekretariatit të programit ISIS II, RCC-së, Shqipërisë, Malit të Zi, Hungarisë dhe Kosovës. Gjatë takimit u propozua drafti i marrëveshjes së bashkëpunimit, e cila ofron një kornizë të përgjithshme të bashkëpunimit ndërmjet shteteve pjesëmarrëse. U diskutua për bashkëpunimin JSPA-RCC (*Regional Cooperation Council ang., Këshilli për bashkëpunim rajonal shq.*) në lidhje me SES 2020 (të arriturat, planet, aktivitetet dhe përkrahjen financiare) si dhe për aktivitetet dhe planet që do të ndërmerren deri në fund të vitit 2016.
- Më 15 dhjetor, në Vjenë të Austrisë, është mbajtur takimi i grupit punues për shkëmbimin e ekspertëve të autoriteteve aeronautike, i cili ishte organizuar nga Iniciativa JSPA në bashkëpunim me RCC-në. Përveç takimit, përfaqësuesit morën pjesë edhe në konferencën për transportin ajror në Ballkanin Perëndimor, poashtu të organizuar nga JSPA dhe RCC. Konferenca, e cila u mbajt më 16 dhjetor në Vjenë, kryesisht mbuloi temat në lidhje me integrimin e hapësirës rajonale të Ballkanit në atë evropiane dhe harmonizimin e strategjive të transportit ajror.

c) Koordinimi i asistencës teknike në fushën e aviacionit

AAC-ja është pikë kontakti për një numër projektesh të asistencës teknike në aviacion, që i ofrohen vendit tonë nga BE-ja, në kuadër të instrumenteve të disponueshme për shtetet që synojnë anëtarësim në BE. Gjatë vitit 2016, AAC-ja ka përfutur nga fondet e BE-së përmes Programit ISIS II, Projektit EASA IPA 3, Projektit BEYOND dhe instrumentit për asistencë teknike TAIEX.

- **Programi ISIS II**

Programi ISIS (Zbatimi i Qiellit të Vetëm Evropian në Evropën Juglindore) është iniciativë e financuar nga Komisioni Evropian për mbështetjen e vendeve të Evropës Juglindore në zbatimin e Qiellit të Vetëm Evropian (SES) dhe të Marrëveshjes HPEA. Objektivat kryesore të këtij programi janë fuqizimi dhe zhvillimi i Autoriteteve Mbikëqyrëse Kombëtare (AMK) në rajon, transponimi i legjislacionit SES në kornizën ligjore të shteteve të rajonit, zbatimi i kulturës së sigurisë dhe krijimi i standardeve për trajnime. AAC-ja është pjesë e këtij programi që nga nënshkrimi i marrëveshjes ISIS mes vendeve të rajonit dhe Komisionit Evropian në prill të vitit 2008. Programi ISIS II është vazhdim i programit të suksesshëm ISIS I, i cili kishte në fokus pakon legjislative SES I. Qëllimi i Programit ISIS II është ofrimi i mbështetjes teknike për vendet e rajonit në fazën e planifikimit dhe përgatitjes për zbatim të plotë të Skemës së Performansës për shërbimet e navigacionit ajror nga viti 2020 e tutje. Më poshtë janë raportuar dy aktivitete të mbajtura në kuadër të këtij programi:

- Më 19 maj 2016 në Prishtinë, ekspertët e programit kanë mbajtur punëtorinë e radhës për stafin e AAC-së dhe ASHNA-s, të involvuar në zbatimin e Skemës së Performansës. Qëllimi i punëtorisë ishte njoftimi me Planin Fillestar të Performancës (2017-2019), çka duhet të përmbajë dhe si duhet të përpilohet nga secili shtet. Shtetet nënshkruese të Marrëveshjes HPEA kanë pasur detyrim që të dorëzojnë në KE Planin fillestar të performancës deri më 1 tetor 2016, detyrim të cilin, siç mund të lexohet më poshtë, AAC-ja e ka përfunduar me kohë.

- Më 2 qershor 2016, me ftesë të Komisionit Evropian, Drejtori i përgjithshëm ka marrë pjesë në takimin final të Organit qeverisës të Programit ISIS II. Ky takim është mbajtur në Tiranë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të AAC-ve të vendeve përfituese nga ky program si dhe përfaqësues të ICAO-s në cilësinë e vëzhguesit. Gjatë takimit është kumtuar edhe përfundimi i këtij programi në shkurt të vitit 2017.
- Projekti EASA IPA 3

Projekti i asistencës teknike i financuar nga KE-ja dhe i implementuar nga EASA ka filluar në fund të vitit 2015 dhe përfundon më 30 qershor 2017. Projekti EASA IPA 3 është vazhdimësi e dy projekteve të mëparshme, prej të cilave ka përfituar Kosova gjatë viteve 2009-2014, dhe ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të mbikëqyrjes së aviacionit civil në shtetet që janë palë të Marrëveshjes HPEA dhe në Turqi. Gjatë vitit 2016, stafi profesional i AAC-së ka përfituar nga këto aktivitete:

1. Seminar për menaxhmentin e lartë, i mbajtur prej 23-26 maj 2016;
2. Seminar për menaxhmentin e mesëm, i mbajtur prej 7-10 qershor 2016;
3. Trajnim në vend pune lidhur me licencimin e personelit që bën mirëmbajtjen e mjeteve ajrore, i mbajtur më 19 e 20 maj 2016;
4. Punëtori mbi sigurinë e pistës, e mbajtur më 28 e 29 qershor 2016
5. Trajnim në vend pune për inspektorë të vlefshmërisë ajrore, i mbajtur prej 6-8 shtator 2016;
6. Punëtori mbi Rregulloren nr. 139/2014 të EASA-s për aerodromet, e mbajtur më 4 e 5 tetor 2016;
7. Takimi i shtatë pan-evropian, i mbajtur më 14 e 15 nëntor 2016;
8. Takimi i dytë i Komitetit Drejtues të projektit, i mbajtur më 16 nëntor 2016.

- Projekti BEYOND

BEYOND është një projekt bashkëpunimi ndërkombëtar i financuar nga Komisioni Evropian nëpërmes Agjencisë Evropiane për Sisteme Globale të Navigimit Satelitor (*ang. European GNSS Agency - GSA*), i cili përfaqëson një aset të rëndësishëm në përkrahje të GSA-së në zbatimin e Sistemit Global Evropian për Navigim Satelitor Galileo. Kosova është përfituese e këtij projekti, ndërsa gjatë vitit 2016 janë mbajtur dy aktivitete të listuara më poshtë:

- Më 23 shkurt 2016, në Podgoricë të Malit të Zi, u mbajt punëtorja me titull “Strategjia PBN në GNSS”. Tema e këtij takimi kishte të bënte me prezantimin e punës së realizuar deri më tani nga pjesëmarrësit në kuadër të këtij projekti.
- Më 27 maj 2016, në Romë të Italisë, u mbajt punëtorja me titull “Skenarët e ardhshëm”. Tema të këtij takimi ishin: përmbledhja e skenarëve të ardhshëm për EGNSS, performanca e LVP200 dhe zona e mbulueshmërisë, përmirësimi i performancës duke përdorur Galileo-n dhe frekuencën e dyfishuar.
- Asistenca teknike TAIEX

Gjatë vitit 2016, AAC-ja ka qenë përfituese e disa punëtorive ose trajnimeve të financuara nga TAIEX, si vijon:

- Prej 3-4 shkurt 2016, AAC-ja e Maqedonisë organizoi në Shkup punëtorinë rajonale për legjislacionin e BE-së në fushën e vlefshmërisë ajrore. Me ftesë të TAIEX-it, trajnimin e kanë ndjekur inspektorët e sigurisë së fluturimeve nga AAC-ja;
- Prej 20-21 prill 2016, AAC-ja e Maqedonisë organizoi në Shkup punëtorinë rajonale për legjislacionin e BE-së në fushën e tarifave në aeroporte dhe në SHNA. Me ftesë të TAIEX-it, trajnimin e kanë ndjekur zyrtarët e rregullimit ekonomik në AAC;

- Prej 13-15 shtator 2016, AAC-ja e Kosovës organizoi punëtorinë “Dizajnimi dhe optimizimi i hapësirës ajrore” në Prishtinë. Punëtorinë e ndoqën pjesëmarrës nga AAC-ja, ASHNA, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Hungaria dhe Republika Çeke;
- Prej 12-16 shtator 2016, inspektorët e aerodromeve të AAC-së kanë bërë një vizitë studimore në Edinburg të Skocisë lidhur me shërbimet e zjarrfikjes dhe shpëtimit në aeroporte.



Nga vizita studimore e inspektorëve të aerodromeve në Skoci, e realizuar përmes instrumentit TAIX

7.10 AKTIVITETI RREGULLATOR

Funksioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës me qëllim të garantimit të operimeve të sigurta në përputhje me standardet në fuqi. Kjo arrihet përmes inspektimit, auditimit, licencimit dhe certifikimit. AAC-ja ka një personel profesional dhe kompetent për rregullimin e aviacionit civil në vend. Republika e Kosovës ka një Ligj për Aviacionin Civil, i cili nga Komisioni Evropian konsiderohet si ligj model për tërë vendet e Ballkanit Perëndimor. Aktiviteti rregullator i AAC-së përfshin sigurinë e aviacionit civil në përgjithësi dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Në vazhdim do të jepet një pasqyrë e përmbledhur e aktiviteteve rregullatore të AAC-së në fushën e sigurisë së aviacionit, të ndara në këto kategori: siguria e fluturimeve, shërbimet e navigacionit ajror dhe aerodromet. Gjithashtu, do të jepet një pasqyrë e përmbledhur edhe për aktivitetet e rregullimit ekonomik në aeroport, në ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror dhe në ofruesit e shërbimeve për aeroplanë në tokë.

a) Siguria e fluturimeve

Gjatë vitit 2016, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve (DSF) ka punuar në mënyrë intensive në hartimin e 16 projekt-rregulloreve, të cilat burojnë nga përditësimi i fundit i Marrëveshjes për Hapësirën Evropiane të Aviacionit. Të gjitha këto projekt-rregullore pritet të hyjnë në fuqi gjatë vitit 2017. Poashtu, DSF-ja ka punuar në mënyrë intensive në hartimin e materialeve të reja udhëzuese,

të cilat lehtësojnë zbatimin e rregulloreve të reja. Janë gjithsej 4 doracakë të rinj, së bashku me rreth 200 formularë, procedura dhe lista kontrolluese përkatëse, të cilët janë punuar dhe kanë filluar të zbatohen.

- Inspektimet e mjeteve të huaja ajrore në platformë

Në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Aviacionin Civil, inspektorët e sigurisë së fluturimeve të AAC-së kanë kryer 54 inspektime të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj (SAFA - Vlerësimi i Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore), të cilët operojnë në ANP “Adem Jashari”.



Inspektori i AAC-së gjatë inspektimit SAFA të aeroplanit në platformën e ANP-së

Janë inspektuar aeroplanët e këtyre kompanive ajrore: Austrian Airlines (AUA); Bulgaria Air (LZB); Time Air (TIE); Easy Jet Switzerland SA (EJS); Smartlynx Airlines (ART); Germanwings (GWI); Adria Airways (ADR); EasyJet Airline Ltd UK (EZY); Belair Airlines AG (BHP); Pegasus Hava Tasimaciligi A.S. (PGT); Germania Flug (GSW); Travel Servis ‘Skytravel’ (TVS); Germania Fluggesellschaft (GMI); MHS Aviation GmbH (MHV); SunExpress (SXS); SunExpress/i huazuar te Turkish Airlines (THY); Corendon Airlines (CAI); Freebird Airlines (FHY); OnurAir (OHY); Norwegian Air Shuttle AS (NAX); AviroAir Airlines (AVG); Air Bucharest (BUR); Swiss International Air Lines (SWR); Scandinavian Airlines System (SAS); Air Alliance Express (YYY); Helvetic Airways AG (OAW); Atlasjet Airlines (KKK); Tuifly (TUI); Aviostart Ltd (VSR); JetairFly (JAF); Croatia Airlines (CTN); Air Pink (PNK); Cobrex (CBX); Aero-Dienst (AND); Jet Story Sp. (JDI); Edelweiss (EDW); Balkan Bulgarian Airlines (LAZ); Fly 365 Aviation (FLA); SprintAir (SRN); Enter Air (ENT); Small Planet (LLX); Bul Air (BVL) dhe SunExpress Deutschland (SXD).

Gjatë këtyre inspektimeve nuk është konstatuar ndonjë gjetje e kategorisë së tretë (me ndikim madhor në siguri), apo ndonjë gjetje e kategorisë së dytë (me ndikim të konsiderueshëm në siguri). Janë konstatuar vetëm dy gjetje të kategorisë së parë (me ndikim të vogël në siguri), për të cilat është informuar piloti komandues dhe është kërkuar marrja e masave përkatëse.

- Auditimet e operatorëve të aviacionit


Më 23 maj 2016, inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve kanë bërë auditimin e organizatës “Kosovo Fly Academy” për vlerësimin e përmbushjes së kushteve për certifikim si organizatë trajnuese për paragjajderë. Më 14 qershor 2016, “Kosovo Fly Academy” u certifikua si organizatë e aprovuar trajnuese për paragjajderë.

Organizatat më poshtë janë audituar me qëllim të vazhdimet të certifikatave për Organizatë të Aprovuar Trajnuese për mallra të rrezikshme:

- Më 24 nëntor 2016 është audituar Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli”;
- Më 8 dhjetor 2016 është audituar ANP “Adem Jashari”;
- Më 23 dhjetor 2016 është audituar kompania ajrore turke “Turkish Airlines”.

• Raportimi i ndodhive në aviacion

Me qëllim të ngritjes së sigurisë në aviacion duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja menaxhon sistemin e raportimit të ndodhive në aviacionin civil, përmes së cilit mbledh informacione relevante për sigurinë e aviacionit civil, bën procesimin e tyre, hetimin, analizimin, ruajtjen, shkëmbimin dhe shpërndarjen e tyre, duke përjashtuar atribuimin e fajit apo përgjegjësisë. Në këtë aktivitet nuk përfshihen incidentet serioze dhe aksidentet, të cilat janë kompetencë e KHAIA-s. Duke u bazuar në analizën e informacioneve të mbledhura, AAC-ja identifikon rreziqet që mund ta cenojnë sigurinë e mjeteve ajrore dhe personave brenda apo jashtë tyre dhe ndërmerr masa adekuatë të sigurisë në kohë të përshtatshme.



Grafikon i nxjerrë nga baza e të dhënave - Ndarja e ndodhive të raportuara sipas kategorisë (fushës së aviacionit)

Ndodhitë të cilat mund të paraqesin rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e aviacionit dhe të cilat kanë të bëjnë me operimin e mjeteve ajrore; me kushtet teknike, mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve ajrore; me shërbimet dhe pajisjet e navigacionit ajror; dhe me aerodromet dhe shërbimet tokësore, duhet të raportohen detyrueshëm nga personat përkatës të përfshirë në këto katër kategori të aviacionit. Ndërsa, detajet e ndodhive, të cilat mund të mos përfshihen në raportimin e detyrueshëm, si dhe informacionet tjera të lidhura me sigurinë, të cilat perceptohen nga raportuesit si rrezik real ose potencial për sigurinë e aviacionit, mbledhen përmes raportimit vullnetar nga personat tjerë që nuk përfshihen në katër kategoritë e cekura më lart.

Gjatë vitit 2016, AAC-ja ka pranuar 130 raporte të ndodhive në aviacion. Ky numër është më i vogël se numri i ndodhive të raportuara gjatë katër viteve të fudit (132 ndodhi në vitin 2015, 174 në vitin 2014

dhe 134 në vitin 2013). Më 4 gusht, në AAC është procesuar ndodhia jubilarë e njëmijte me radhë që nga viti 2006, ndërsa deri në fund të vitit 2016 ky numër ka arritur në gjithsej 1,063 ndodhi.

Ndodhitë e raportuara janë ndarë sipas kategorisë (fushës së aviacionit) dhe bashkë me ndodhitë e tre viteve të kaluara janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm, i cili është nxjerr nga baza e të dhënave e AAC-së në softuerin ECCAIRS 5 (Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve):

Nga grafiku mund të shihet që ka vazhduar trendi i rënies së ndodhive të lidhura me menaxhimin e trafikut ajror (ATM), ndërsa numri i goditjeve të shpezeve (BIRD), pas një rënieje, është kthyer në nivelin mesatarisht të lartë. Po ashtu, mund të vërehet që sulmet me laser (ndriçimi i mjeteve ajrore me dritë laserike), të përfshira në kategorinë (SEC), kanë pësuar një rënie të konsiderueshme duke iu afruar nivelit të vitit 2013. Më 2016 është shfaqur një kategori e re (RI-A), e raportuar në tre vitet e mëparshme, e lidhur me futjen në pistë dhe pjesët tjera manovruese të kafshëve në ANP “Adem Jashari”, ku janë raportuar 8 ndodhi të futjes së qenve dhe një ndodhi e futjes së një shpendi. Po ashtu, është shfaqur edhe një ndodhi e re, aktiviteti i paautorizuar me dron. Gjatë vitit 2016 janë raportuar dy ndodhi të tilla, të cilat janë futur në kategorinë *Të tjera* (OTHR). Tri nga ndodhitë e raportuara janë të përfshira në dy kategori.

- Transporti i mallrave të rrezikshme përmes ajrit

Në bazë të nenit 57 dhe 59 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe nenit 8.1 të Rregullores nr. 8/2014 për kushtet dhe mënyrën e transportimit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2016 janë lëshuar gjithsej 58 leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit, kompanive ajrore që operojnë në ANP “Adem Jashari” Prej tyre 54 leje i janë lëshuar “Turkish Airlines”, tri leje i janë lëshuar “Pegasus Hava Tasimaciligi A.S.” dhe një leje i është lëshuar “Croatia Airlines”.

Këto leje u janë lëshuar kompanive ajrore, që transportojnë në Kosovë, dërgesa për pranuesit e mallrave, të cilët pranues paraprakisht janë licencuar dhe posedojnë leje për import të armëve dhe municionit, të lëshuar nga ana e MPB-së.

AAC-ja është fokusuar në zbatimin e kërkesave ligjore të dala nga Rregullorja nr. 8/2014 për kushtet dhe mënyrën e transportimit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit, lidhur me certifikimin e operatorëve ajrorë të cilët transportojnë mallra të rrezikshme përmes ajrit si dhe ofruesve të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjentëve të trajtimit të mallrave të rrezikshme. Në këtë rrjedhë, më 7 shtator 2016, një inspektor i vlefshmërisë ajrore i AAC-së ka marrë pjesë në tryezën e rumbullakët “Shërbimet universale dhe liberalizimi i tyre në një treg konkurrues postar”, të organizuar nga Kolegji “Tempulli”, ku ka prezantuar kërkesat e Rregullores së AAC-së nr. 8/2014 sa i përket trajnimit të personelit të postave, postave të shpejta dhe agjentëve për trajtimin e mallrave të rrezikshme që transportohen përmes ajrit.

AAC-ja ka rishikuar materialet e përditësuara të kursit të ANP “Adem Jashari” për mallrat e rrezikshme, të dedikuara për personelin e pritje-përcjelljes së udhëtarëve (kategoria 9 e ICAO-së) dhe personelin e skenimit të sigurimit (kategoria 12 e ICAO-së), dhe më 23 shkurt 2016 i ka aprovuar formalisht këto ndryshime. Po ashtu, janë lëshuar 60 numra të regjistrimit të pjesëmarrësve të kursit. Aprovimi i këtij kursi ishte i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2016.

Gjatë muajit mars është monitoruar mbajtja e kursit fillestar trajnues të ANP “Adem Jashari” për mallra të rrezikshme, për personelin e pritje-përcjelljes së udhëtarëve (kategoria 9 e ICAO-së) dhe personelin e skenimit të sigurimit (kategoria 12 e ICAO-së).

Më 3 qershor 2016, stafi i AAC-së është takuar me përfaqësuesit e shpeditërëve (postave të shpejta) dhe dërguesve të mallrave për nevojën e trajnimit të personelit të tyre sipas dispozitave të Rregullores

nr. 8/2014 të AAC-së për kushtet dhe mënyrën e transportimit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit. Ata janë ftuar në takim për të përcaktuar nivelin e nevojshëm të trajnimit, varësisht nëse ata ofrojnë apo jo dërgesa të mallrave të rrezikshme për transport ajror përmes ANP "Adem Jashari". Një pjesë e tyre kanë ofruar dëshmi për trajnimet e kryera, ndërsa pjesa tjetër është në dijeni për nevojën e trajnimeve dhe janë në plotësim e sipër të kushteve të përcaktuara nga AAC-ja.



Aktivitet me paraglajd

Janë vlerësuar materialet e kursit të ANP "Adem Jashari" LKIA për mallrat e rrezikshme, të dedikuara për personelin e platformës dhe personelin e depos (kategoritë 8 dhe 5 të ICAO-s) dhe më 13 tetor 2016 është aprovuar ky kurs periodik, i cili është mbajtur në gjuhën shqipe.

Është përpiluar lista e postave të shpejta dhe shpeditëve, si dhe është identifikuar personeli i tyre i cili është i trajnuar për trajtimin e mallrave të rrezikshme për transportim përmes ajrit.

• Mbikëqyrja e aviacionit të përgjithshëm

Gjatë vitit ka pasur një numër të shtuar aktiviteteve të aviacionit të përgjithshëm, ku përfshihen fluturimet GAT-VFR, paraglajdingu, operimet me dron etj., të cilat, në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil dhe rregulloreve përkatëse, kanë kaluar nëpër procesin e miratimit nga AAC-ja. Në vazhdim janë dhënë më shumë detaje mbi këto aktivitete.

Fluturimet GAT-VFR

Janë pranuar 39 kërkesa për fluturim sipas rregullave vizuale të fluturimit (GAT VFR), 35 prej të cilave janë aprovuar nga AAC-ja në koordinim me njësitin ajror të KFOR-it (J3Air).

Licencimi i pilotëve të paraglajdit dhe aktivitetet me paraglajd

Inspektorët e sigurisë së fluturimeve kanë punuar në përditësimin dhe plotësimin e Katalogut të pyetjeve të testit teorik për licencë të pilotit të paraglajdit si dhe privilegjeve të instruktorit. Ky katalog është plotësuar me pyetje shtesë për kategorinë e instruktorëve të paraglajdzimit. Katalogu i përditësuar është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së në internet më 16 mars 2016.

Më 26 mars 2016 është organizuar testi teorik për kandidatët e rinj për licencë të paraglajdit si dhe për kandidatët që kanë aplikuar për marrjen e gradës së instruktorit të paraglajdzimit. Në test kanë marrë pjesë gjithsej 16 kandidatë, të cilët me sukses kaluan testin teorik. Në pjesën praktike të provimit, të mbajtur më 13 prill në kodrën e Goleshit në afërsi të ANP "Adem Jashari", të gjithë 16 kandidatët kaluan me sukses provimin praktik.

Janë aprovuar kërkesat e Federatës Aeronautike të Kosovës për akvite me paraglajd si vijon:

- për kampionatin e pestë kombëtar në paraglajdzim, i mbajtur më 15-16 prill 2016;
- për kampionatin e gjashtë kombëtar në paraglajdzim, i mbajtur më 2-3 korrik 2016;
- për kampionatin ndërkombëtar në paraglajdzim, i mbajtur më 5-6 nëntor 2016.

Aktivitetet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot

Janë pranuar 28 kërkesa për operate me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (RPAS), apo siç njihen ndryshe “dron”. Këto leje u janë lëshuar subjekteve në përputhje me kushtet e parapara me Rregulloren nr. 6/2014 të AAC-së.

- Mjekësia e aviacionit

Spektori i mjekësisë së aviacionit funksionon në kuadër të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve dhe është përgjegjës për verifikimin e gjendjes shëndetësore të disa kategorive të personelit që licencohen nga AAC-ja.

Më 18 janar 2016 u realizua një inspektim i Qendrës Aero-Mjekësore në Gjakovë. Ky inspektim u krye në bazë të kërkesave të cilat dalin nga Rregullorja nr. 5/2015 e AAC-së që përcakton procedurat teknike dhe administrative në lidhje me personelin e aviacionit civil.

Pas kryerjes së ekzaminimeve mjekësore nga aplikuesit në Qendrën Aero-Mjekësore të Gjakovës, Spektori i Mjekësisë së Aviacionit ka lëshuar certifikatat mjekësore si në vijim:

- Shtatë kontrollorëve të trafikut ajror të ASHNA-s u janë vazhduar certifikatat mjekësore të Klasës 3;
- Nëntë kandidatëve, pjesëtarë të Federatës Aeronautike të Kosovës, u janë lëshuar certifikatat mjekësore të Klasës 2;
- Pesë anëtarë të ekuipazhit të kabinës të kompanisë ajrore sllovene “Adria Airways” janë pajisur me raporte mjekësore;
- Një piloti të helikopterit nga kompania “Shega-Air”, Shqipëri, i është lëshuar certifikatë mjekësore e Klasës 2;
- Një kontrollori të ofruesit të shërbimeve të navigimit ajror nga Republika e Shqipërisë “Alb-CONTROL”, i është vazhduar vlefshmëria e certifikatës mjekësore të Klasës 3 edhe për një vit.

Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit me AAC-në e Shqipërisë, që nga viti 2014 personeli i aviacionit i licencuar nga AAC-ja e Shqipërisë shfrytëzon shërbimet e ofrimit të ekzaminimeve aero-mjekësore nga Qendra Aero-Mjekësore në Gjakovë. Poashtu, nga shkurti i vitit 2014, shërbimet e ekzaminimeve aero-mjekësore i marrin edhe një pjesë e personelit të kabinës (stjuardesa dhe stjuardë) të kompanisë ajrore sllovene “Adria Airways”.

Gjatë kësaj periudhe është bërë vazhdimi i ushtrimit të privilegjeve të Ekzaminuesit të autorizuar mjekësor (AME), i vlefshëm 3 vjet, për Dr. Naim Bardiqi, siç parashihet me Rregulloret nr. 5/2015 dhe 5/2012 të AAC-së.

- Mjetet ajrore të ndaluara në Kosovë

Sipas nenit 45 të Ligjit për Aviacionin Civil, aeroplanët e kompanive ajrore që u është ndaluar nga BE-ja të operojnë në hapësirën ajrore të shteteve anëtare të BE-së, nuk janë lejuar të fluturojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Për më tepër, lista e përditësuar e BE-së e kompanive ajrore të ndaluara është e postuar në faqen zyrtare të AAC-së në internet. Gjatë vitit 2016 nuk është realizuar asnjë fluturim i ndonjë kompanie nga kjo listë e BE-së në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

- Licencat, certifikatat dhe lejet e aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre

Licencë/certifikatë/leje	Referenca në LAC/ Rregullore	Numri
Leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit	Neni 57	58
Leje për operime të aviacionit të përgjithshëm (GAT VFR)	Neni 2 dhe 75	35
Leje për operime me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (RPAS)	Rregullore 6/2014	28
Licenca për pilot të paragjajdit	Rregullore 1/2012	16
Certifikatë mjekësore, klasa 3	Neni 37	7
Certifikatë mjekësore, klasa 2	Neni 37	10

Paraqitje e certifikatave dhe lejeve të lëshuara nga AAC-ja për operatorë/personel

b) Shërbimet e navigacionit ajror

• Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA)

Më 1 janar 2016, në bazë të Ligjit nr. 04/L-250, është themeluar Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si entitet pasardhës i Kontrollit Ajror – ANP “Adem Jashari” sh.a. Kjo agjenci ofron shërbimin e kontrollit të trafikut Ajror (KTA), shërbimin për komunikim, navigim dheurvej (KNS), shërbimin e informatave aeronautike (SHIA) dhe shërbimin meteorologjik (METEO) në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës. ASHNA ka gjithsej 32 kontrollorë të trafikut ajror, të cilët janë të licencuar nga AAC-ja në bazë të Rregullores nr. 5/2012 të AAC-së mbi licencimin e kontrollorëve të trafikut ajror.

• Certifikimi i ASHNA-s

Certifikimi i ASHNA-s nga ana e AAC-së është obligim që parashihet me legjislacionin në fuqi (Rregulloren nr. 12/2010 të AAC-së) dhe ka për qëllim të verifikojë se niveli i sigurisë së shërbimeve të ofruara mbetet vazhdimisht në nivelin e duhur dhe kështu mundëson që transporti ajror në Kosovë të realizohet në mënyrë të sigurt.

Në bazë të konfirmimit të përmbushjes së kërkesave të sigurisë për certifikim nga Departamenti i SHNA-së, ekonomike-financiare nga Departamenti i BNRREA-së dhe atyre të sigurimit të aviacionit civil nga MPB-ja, Drejtori i përgjithshëm i AAC-së, më 19 gusht 2016, e ka certifikuar ASHNA-n. Kjo certifikatë ka vlefshmëri për një periudhë 5 vjeçare dhe mbulon ofrimin e këtyre shërbimeve: shërbimet e trafikut ajror (KTA), shërbimet e komunikimit, navigimit dheurvej (KNS), shërbimet e informatave aeronautike (SHIA) dhe shërbimet meteorologjike (MET). Certifikata u lëshua në bazë të nenit 78 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe kriterëve të sigurisë, qëndrueshmërisë ekonomike dhe sigurimit që dalin nga Rregulloret nr. 9/2009 dhe nr. 7/2012, që transponojnë në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës Rregulloren (KE) nr. 550/2004 dhe Rregulloren (KE) nr. 1035/2011 përkatësisht.

Procesi i certifikimit ka filluar në vitin 2011, kur ASHNA, e cila atë kohë ende ishte ndërmarrje publike, dorëzoi për herë të parë aplikacionin për certifikim. Që nga ajo kohë ASHNA ka vazhduar plotësimin e dokumentacionit përkatës, siç janë Pyetësorët e Certifikimit dhe dokumentet e organizatës si dhe ka përditësuar ato kur ka qenë nevoja. Gjatë kësaj periudhe Departamenti i SHNA-së ka realizuar njëmbëdhjetë auditime të sigurisë në këtë organizatë, siç parashihet me procedurën e lartcekur. Auditimi i fundit, i mbajtur më 16-22 qershor 2016 në ASHNA si dhe auditimet e planifikuara dhe përcjellëse të realizuara më parë në këtë Agjenci, dhanë rezultatin e tyre përfundimtar dhe vërtetuan që ofruesi i vetëm i shërbimeve të navigimit ajror në Kosovë plotëson kërkesat e sigurisë për certifikim.

AAC-ja ka hezituuar deri në fund të vitit 2015 ta certifikojë ASHNA-n për shkak të qëndrueshmërisë



Ceremonia e dorëzimit të certifikatës ASHNA-s

së dobët financiare që kishte gjatë funksionimit të saj si ndërmarrje publike dhe ndikimit negativ që kjo situatë financiare mund të kishte në sigurinë e operimeve. Sidoqoftë, kapaciteti i mirë financiar dhe ekonomik që është kërkesë për certifikim është përmirësuar me fillimin e vitit 2016 me faktin që ASHNA është përfshirë si organizatë e pavarur buxhetore në Ligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës. Statusi i organizatës buxhetore ia mundëson ASHNA-s që të mbulojë shpenzimet operative dhe kapitale dhe poashtu të përfitojë grante për investimet më të mëdha, të nevojshme për të ofruar shërbime në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës në të ardhmen.

AAC-ja do të vazhdojë mbikëqyrjen e ASHNA-s për të garantuar mirëmbajtjen e certifikatës dhe siguruar se standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e sigurisë dhe ato ekonomike respektohen në vazhdimësi. Në rast të degradimit të shërbimeve të ofruara dhe mosplotësimit të vazhdueshëm të standardeve, AAC-ja ka të drejtën e revokimit të certifikatës.

- **Mbikëqyrja e vazhdueshme e ASHNA-s**

Në kuadër të mbikëqyrjes së vazhdueshme të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, inspektorët e AAC-së kanë realizuar auditimin gjithëpërfshirës për certifikimin e ASHNA-s, përfshirë auditimin nga EASA, si dhe një vizitë inspektuese:

- Më 13 janar 2016 është realizuar një vizitë inspektuese në ambientet e ASHNA-s me qëllim të kërimit të disa dokumenteve shtesë në lidhje me dosjen e sigurisë të dorëzuar më herët në AAC për ndryshimin CH/2013/06, i cili ka të bëjë me rilokimin e operimeve të njësive TWR dhe APP në objektet e reja. Këto dëshmi lidhen me trajnimet e nevojshme për kontrollorë dhe stafin teknik. Poashtu, vizita ndërlidhej edhe me disa ndodhi të raportuara gjatë muajit dhjetor, të cilat ishin duke u hetuar nga ana e AAC-së.
- Gjatë periudhës 16-22 qershor, AAC-ja ka realizuar një auditim të planifikuar në ASHNA. Ky auditim është realizuar me përkrahje nga z. Franck Giraud, ekspert nga AAC-ja e Francës, në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim të nënshkruar mes dy AAC-ve. Qëllimi kryesor i këtij auditimi ka qenë verifikimi i përgjithshëm i kërkesave të cilat dalin nga Rregullorja nr. 7/2012 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, me fokus në zbatimin e kërkesave të Aneksit II të kësaj rregulloreje. Në veçanti, duke pasur parasysh edhe trendin në

rënie të raporteve të obligueshme të ndodhive, auditorët janë fokusuar në pikat e rregullores që kanë të bëjnë me raportimin dhe hetimin e ndodhive, shpërndarjen e mësimave të nxjerra te stafi dhe zbatimi i rekomandimeve që dalin nga hetimet dhe vlerësimet e sigurisë.

Në përgjithësi, ekipi auditues është ndarë shumë i kënaqur me bashkëpunimin e stafit të ASHNA-s si në ndarjen e informatave, poashtu edhe në ofrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e auditorëve dhe në përgjithësi është raportuar për frymë dhe qasje pozitive drejt ngritjes së vazhdueshme të sigurisë në ASHNA. Gjatë këtij auditimi nuk u hap asnjë gjetje e re, ndërsa u mbyll një gjetje nga auditimet e kaluara.

- **Certifikimi i ASHNA-s si organizatë trajnuese**

Më 18 tetor 2016, ASHNA ka dorëzuar aplikacionin për certifikim si organizatë trajnuese në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 5/2012 të AAC-së. Bashkë me aplikacionin, ASHNA ka dorëzuar edhe dokumentet përkatëse siç kërkohen me këtë rregullore dhe procedurat e brendshme të AAC-së. AAC-ja ka vlerësuar dokumentacionin e kërkuar dhe e ka konsideruar si të pranueshëm. Pas gjetjeve që janë identifikuar në ASHNA nga ekipi auditues i EASA-s, AAC-ja ka kërkuar amandamentimin e Programit të Trajnimit për Njësi (UTP) dhe Skemës së Kompetencës (UCS). Procesi i certifikimit pritet të vazhdojë në tremujorin e parë të vitit 2017.

- **Auditimi vlerësues nga EASA**

Më 21-25 nëntor, Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit (EASA) ka bërë një auditim vlerësues në AAC-në e Kosovës, me theks të veçantë në fushën e menaxhimit të trafikut ajror dhe shërbimeve të navigacionit ajror. Ky proces ishte hapi i radhës në formalizimin e marrëdhënieve mes EASA-s dhe AAC-së së Kosovës. Qëllimi i këtij auditimi ishte vlerësimi i gjendjes në AAC dhe në Agjencinë për Shërbime të Navigacionit Ajror në lidhje me plotësimin e kërkesave që dalin nga legjislacioni përkatës i BE-së, i transponuar në rendin ligjor të Republikës së Kosovës nga AAC-ja.

Gjatë këtij auditimi, ekipi i auditorëve i përbërë nga tre ekspertë të lëmisë vizituan Departamentin e SHNA-së në AAC dhe ASHNA-n, ndërsa mbajtën takime edhe me departamentin BNRREA të AAC-së, që është përgjegjës për rregullimin ekonomik të ASHNA-s, dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, përgjegjëse për sigurimin e aviacionit civil. Gjatë auditimit, me theks të veçantë u inspektuan procesi i lëshimit të licencave të kontrollorëve dhe mbikëqyrjes së organizatave trajnuese, procesi i certifikimit të ASHNA-s dhe mbikëqyrja e vazhdueshme që i bëhet ASHNA-s përmes rishikimit të ndryshimeve dhe planifikimit dhe organizimit të rregullt të auditeve në ASHNA nga ana e AAC-së. Përveç këtyre proceseve, u verifikuan edhe përmbushja e kërkesave ligjore në lidhje me strukturën dhe organizimin e AAC-së si dhe nxjerrjen dhe zbatimin e rregulloreve sipas kërkesave që dalin nga legjislacioni i BE-së dhe standardet ndërkombëtare të ICAO-s. Gjatë vizitës në ASHNA, auditorët patën rastin të shohin dhe vlerësojnë punën e ASHNA-s, nivelin e zbatimit të rregulloreve përkatëse si dhe të shohin në praktikë frytet e punës së AAC-së.

Ndonëse AAC-ja ende nuk ka pranuar raportin zyrtar nga EASA në lidhje me këtë auditim, gjatë takimit përmbyllës, ekipi i auditorëve njoftoi AAC-në se ishin identifikuar 23 observime në AAC dhe 18 në ASHNA. Nga këto observime vetëm njëra, që kishte të bëjë me menaxhimin e stresit në punë, u konsiderua me ndikim më serioz në siguri, ndaj edhe AAC-ja ndërmori hapa të menjëhershëm për adresimin e tij. Ekipi auditues falënderoi stafin e AAC-së për bashkëpunim dhe mikëpritje si dhe e përgëzoi atë për dedikimin në punë dhe gatishmërinë për përmirësim të vazhdueshëm. Numri i observimeve, sipas ekipit auditues të EASA-s, është në përpjestim të njëjtë me mesataren e shteteve anëtare të BE-së.

Më 2 dhjetor 2016, ka përgatitur planin me hapa korrektues për adresimin e observimeve, ndërsa më 8 dhjetor është mbajtur një takim me ASHNA-n për të diskutuar gjetjet e identifikuara në organizatën e tyre dhe hapat për adresimin e tyre.

- Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s

ASHNA është shumë e ndjeshme ndaj rreziqeve që mund të ndodhin gjatë punës së përditshme. Qëllimi kryesor i këtyre shërbimeve është parandalimi i përplasjeve të avionëve në ajër dhe në tokë.

Për këtë arsye, sistemi i menaxhimit të sigurisë kërkon që para çdo ndryshimi, sado i vogël që të jetë ai, në sistemet e ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror të merren hapat e duhur për t'u siguruar se ndryshimi i bërë nuk do të shkaktojë rrezik të patolerueshëm në sistem. Sipas Rregullores nr. 6/2012 të AAC-së, që transponon në rendin tonë të brendshëm ligjor Rregulloren nr. 1034/2011 të KE-së, ofruesit e këtyre shërbimeve janë të obliguar të njoftojnë AAC-në për çfarëdo ndryshimi të planifikuar që mund të ketë ndikim në siguri; dhe sipas Rregullores nr. 7/2012, që transponon Rregulloren nr. 1035/2011 të KE-së, të bëjnë vlerësimin e rreziqeve të mundshme dhe të marrin të gjithë hapat e nevojshëm parandalues për evitimin e tyre, para se të fillojnë me zbatimin e ndryshimeve.

Gjatë vitit 2016, AAC-ja nuk është njoftuar për ndonjë ndryshim të planifikuar në sistemet e ASHNA-s, por ka bërë monitorimin e vazhdueshëm të ndryshimeve të njoftuara më herët. Më konkretisht, ka mbikëqyrë ndryshimin CH/2013/06 "Rilaokimi i njësive TWR dhe APP", dhe pas shqyrtimit me kujdes të dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të sigurisë gjatë



Kulla e kontrollit ajror të ASHNA-s

disa auditimeve dhe vizitave inspektuese. përfshirë dosjen e sigurisë "safety case", më 15 janar 2016 ka pranuar futjen në operim të këtij ndryshimi.

- Lëshimi i licencave për kontrollorët e trafikut ajror dhe vlerësimi i gradimeve

AAC-ja është përgjegjëse për lëshim dhe ripërtëritjen e licencave të kontrollorëve të trafikut ajror, të cilët ofrojnë shërbimet e kontrollit ajror në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror në sigurinë e fluturimeve, kontrollorët duhet të përmbushin një varg të kërkesave dhe kushteve për të mirëmbajtur licencat dhe miratimet e tyre, të cilat dalin nga Rregullorja nr. 5/2012 mbi licencimin e kontrollorëve të trafikut ajror. Kërkesat kryesisht ndërlidhen me nivelin e kompetencës profesionale, që përfshijnë ndjekjen e trajnimeve profesionale përditësuese dhe ushtrimin e detyrave të kontrollorit të trafikut ajror për një numër të caktuar të orëve brenda vitit. Kontrollorët gjithashtu, në baza vjetore, i nënshtrohen vlerësimit profesional për të verifikuar nivelin e aftësive.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe zotërimit të gjuhës angleze, pasi që komunikimi në aviacionin

ndërkombëtar bëhet në këtë gjuhë. Niveli i zotërimit të gjuhës angleze vlerësohet në mënyrë periodike dhe merret parasysh gjatë lëshimit apo ripërtëritjes së licencës. AAC-ja ka për detyrë të garantojë nivel të lartë të sigurisë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, andaj çdo vit verifikon përmbushjen e këtyre kërkesave dhe, në bazë të kësaj, licencën kontrollorët e trafikut ajror. Kontrollorët gjithashtu duhet të kenë shëndet të mirë, në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kjo verifikohet në mënyrë të rregullt nga seksioni i mjekësisë së aviacionit në AAC, si pjesë e procesit të licencimit.

Gjatë vitit 2016, AAC-ja ka vazhduar gradimin për vlerësues të kompetencës për 3 kontrollorë të trafikut ajror (KTA), ka lëshuar miratimin e gradimeve për instruktor për 10 KTA, ka rivaliduar miratimin e njësive njëherë për 5 KTA, ndërsa në dhjetor ka vazhduar miratimet e njësive për 26 KTA të tjerë.

Licencimi i Kontrollorëve të Trafikut Ajror (KTA)	Numri i të licencuarve
Ripërtëritja e licencave për KTA	26
Rivalidim i gradimeve	3+10+5
Licencimi i studentëve KTA	0
Licencim i KTA-ve	0

• Plani Kombëtar i Performancës për SHNA

Me hyrjen në fuqi të Rregulloreve nr. 1/2016 dhe 3/2016 në fillim të vitit 2016, AAC-ja ka filluar të punojë drejt zbatimit të Skemës së Performancës për shërbimet e navigacionit ajror. Në kuadër të kësaj skeme parashihet planifikimi afatgjatë i performancës dhe vendosja e caqeve të performancës në katër fusha kyçe: siguri, kapacitet, mjedis dhe efikasitet të kostos.

Faza kalimtare e zbatimit do të realizohet në periudhën 2017-2019, ndërsa zbatimi i plotë i Skemës së Performancës do të fillojë nga viti 2020 e tutje. Gjatë fazës kalimtare AAC-ja do të përpilojë dhe zyrtarizojë Planin Fillestar Kombëtar të Performancës, do të monitorojë përmbushjen e caqeve të performancës dhe do të mbledhë të dhëna statistikore për të ardhmen. Nga viti 2020, Republika e Kosovës do të jetë e obliguar të zbatojë Planin e Performancës, të garantojë arritjen e caqeve të performancës të vendosura në nivel të Bashkimit Evropian, si dhe të monitorojë zbatimin e planit dhe t'i raportojë në baza vjetore Komisionit Evropian. Plani i hollësishëm i punës për arritjen deri te zbatimi i plotë i Skemës së Performancës, i cili është punuar në kuadër të Programit ISIS II, është formalizuar në dokumentin "Udhërrëfyti i Kosovës në drejtim të zbatimit të Skemës së Performancës SES".

Në muajin gusht është mbajtur një takim konsultues me përfaqësues të Komisionit Evropian dhe Organit për Rishikimin e Performancës (ORP) në Bruksel, njësi kjo e cila merret me rishikimin dhe aprovimin e planeve të performancës në nivel evropian. Në këtë takim u diskutua situata e veçantë e Republikës së Kosovës nga perspektiva e Rregullores për Performancë, hapësira e lartë ajrore si dhe koordinimi dhe shkëmbimi i të dhënave me Menaxherin e Rrjetit që funksionon brenda ORP-së dhe bën menaxhimin dhe planifikimin e trafikut ajror në Evropë.

Grupet punuese të përbëra nga ekspertë të AAC-së dhe ASHNA-s kanë punuar në mbledhjen e të dhënave për përpilimin e trendeve historike në tri fushat kyçe të performancës: siguri, kapacitetit dhe efikasitetit të kostos (indiktorët për fushën e mjedisit për momentin nuk janë të aplikueshëm në Kosovë). Pas përpilimit të këtyre trendeve, grupet punuese propozuan edhe caqet fillestare të

përformansës në këto tri fusha për tre vitet e ardhshme (2017-2019). Vlerat e arritura u diskutuan edhe në tre takime konsultuese që u mbajtën gjatë muajit shtator me ASHNA-n. Pas dakordimit, u finalizua Plani Fillestar i Performancës, i cili më 30 shtator 2016 u dërgua te Organi për Rishikimin e Performancës për vlerësim dhe komente të mëtutjeshme.

- Publikimi i Informatave Aeronautike

Në bazë të Rregullores nr. 5/2013 të AAC-së për zbatimin e Shtojcës 15 të Konventës Ndërkombëtare për Aviacionin Civil për shërbimet e informimit aeronautik, AAC-ja ka përgjegjësi që të publikojë dokumentin “Publikimi i Informatave Aeronautike”, i njohur sipas akronimit në anglisht si AIP (*Aeronautical Information Publication*). Ky është një dokument shtetëror i një rëndësie të veçantë, në të cilin publikohen të gjitha informatat në lidhje me aviacionin e një shteti. Dokumenti në vete përmban tre kapituj: kapitulli i parë përmban informata të përgjithshme për aviacion, i dyti ka të bëjë me hapësirën ajrore dhe kapitulli i tretë ka të bëjë me specifikat e detajuara për secilin aeroport/heliport, përfshirë edhe procedurat e fluturimit për aeroplanët.

Meqë ky publikim përdoret në masë të madhe nga kompanitë ajrore që operojnë ose synojnë të operojnë në Kosovë, AAC-ja kujdeset që AIP i Kosovës të mbahet i azhurnuar dhe secili ndryshim që ndodh në lidhje me aviacionin civil brenda shtetit të reflektohet në këtë dokument. Këto ndryshime janë të rregullta dhe bëhen përmes amandamentimeve në cikle të caktuara çdo 28 ditë, përmes të të ashtuquajturit Kontrolli dhe Rregullimi i Informatave Aeronautike (KRIA) (ang. *Aeronautical Information Regulation and Control - AIRAC*) dhe bëhen efektive çdo 56 ditë.

Gjatë këtij viti janë aprovuar dhe publikuar në Publikimin e Informatave Aeronautike pesë amandamentime dhe një cikël i AIRAC-ut. Është publikuar AIP AMDT 01/2016, i cili ka hyrë në fuqi më 28 prill, AIP AMDT 02/2016, i cili ka hyrë në fuqi më 23 qershor, AIP AMDT 03/2016, i cili ka hyrë në fuqi më 15 shtator, AIP AMDT 04/2015, i cili ka hyrë në fuqi më 10 nëntor dhe AIP AMDT 05/2016, i cili ka hyrë në fuqi më 18 nëntor. Poashtu është publikuar edhe cikli AIP AIRAC 01/2016, i cili është bërë efektiv nga data 12 shkurt 2016.

Publikimi më aktual i informatave aeronautike është i qasshëm në çdo kohë në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

c) Aerodromet

Mbikëqyrja rregullatore dhe e sigurisë së aerodromeve arrihet përmes certifikimit, aprovimit dhe regjistrimit të aerodromeve, aprovimit të ofruesve të shërbimeve në tokë, kryerjes së auditimeve dhe inspektimeve, si dhe përmes monitorimit të aktiviteteve për të verifikuar dhe siguruar përputhshmëri me standardet dhe legjislacionin relevant.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” është certifikuar më 1 dhjetor 2008 nga AAC-ja si aeroport ndërkombëtar në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil dhe Rregulloren e AAC-së nr. 1/2008 për aerodromet. Në vitin 2011 aeroporti është dhënë në koncesion dhe menaxhimi i tij ka kaluar te operatori privat, konzorciumi turko-francez “Limak - Aéroports de Lyon” (“Limak Kosovo International Airport” sh.a.). Më 8 nëntor 2013, bazuar në kërkesat ligjore, me rastin e transferimit të operimeve në terminalin e ri, AAC-ja ka amandamentuar certifikatën e operatorit “Limak Kosovo International Airport” sh.a. (LKIA).

Në bazë të Rregullores nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, më 1 janar 2012 AAC-ja ka aprovuar “Ex Fis” sh.p.k. si furnizues i shërbimeve në tokë për kategorinë e shërbimeve të furnizimit me derivate dhe vajra, kurse më 1 qershor 2012 AAC-ja ka aprovuar LKIA-në si ofrues të disa kategorive të shërbimeve të aeroplanit në tokë në ANP “Adem Jashari”.

Më 28 gusht 2014, AAC-ja ka aprovuar heliportin e parë në Republikën e Kosovës. Operatori “Kosovo Air Service” sh.p.k. është aprovuar që të operojë heliportin që gjendet në fshatin Përlepnice

të Gjilanit, në kuadër të kompleksit afarist "Vali Ranch". Sidoqoftë, më 21 shtator 2016, AAC-ja ka pranuar njoftim zyrtar nga Drejtori Ekzekutiv i "Kosovo Air Service" sh.p.k., lidhur me ndërprerjen e operimeve në heliport. Duke u bazuar në shkresën e pranuar, në mbështetje të neneve 14.2 dhe 21.2 të Ligjit për Aviacionin Civil dhe në pajtim me nenin 10.2 të Rregullores nr. 3/2012 mbi aerodromet e aprovuara, AAC-ja ka marrë vendim për anulimin e aprovimit të heliportit. Kjo informatë është dërguar edhe në Shërbimin e informimit aeronautik (AIS), për të reflektuar anulimin në Publikimin e Informative Aeronautike (AIP).

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e sigurisë së aerodromeve

Sipas planit të aktiviteteve për monitorimin e rregullt të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", ofruesve të shërbimit në tokë dhe heliportit "Vali Ranch", për të verifikuar kompetencën organizative dhe kapacitetin e tyre, gjatë vitit 2016 Departamenti i Aerodromeve ka kryer dhjetë inspektime dhe një auditim të rregullt.

Auditimi i LKIA-së, si ofrues i shërbimeve në tokë, ka pasë për qëllim verifikimin e zbatimit në praktikë të procedurave standarde të sigurisë për ofrimin e shërbimeve në tokë, verifikimin në praktikë të kompetencës së personelit dhe pajisjet për ofrimin e këtyre shërbimeve.



C5 Galaxy i Forcës Ajrore Amerikane, një nga aeroplanët më të mëdhenj që kanë operuar në ANP

Inspektimet e lartpërmendura janë fokusuar në verifikimin e zbatimit të standardeve të aplikueshme për operatorin LKIA të ANP "Adem Jashari", siç janë zbatimi i masave për menaxhimin e botës shtazore, zbatimi i procedurave për monitorim të objekteve brenda aeroportit dhe jashtë tij, të cilat potencialisht mund të konsiderohen si pengesa për operime, zbatimi i procedurave dhe masave për mbikëqyrjen e sistemeve për furnizimin me energji elektrike në aeroport, etj. Gjithashtu, është bërë edhe inspektimi i shërbimit të furnizimit të aeroplanëve me karburant dhe një inspektim në heliportin "Vali Ranch" në fshatin Përlepnice të Gjilanit.

Departamenti i Aerodromeve ka bërë edhe vlerësimin e procedurave të reja nga ofruesi i shërbimit të furnizimit të aeroplanëve me karburant "Ex Fis" sh.p.k., është aprovuar Programi i Trajnimeve të operatorit LKIA, janë zhvilluar takimet me KFOR-in lidhur me zbatimin e projektit të heliporteve ushtarake, janë aprovuar vlerësimet e sigurisë lidhur me zbatimin e projekteve dhe procedurave të ndryshme në aeroport, manualët, procedurat, hartat. Si pjesë e grupit punues ndërinstitucional, të formuar nga Qeveria e Kosovës, është bërë studimi i fizibilitetit për zgjatjen e pistës dhe ngritjen e kategorisë së pistës në ANP "Adem Jashari" nga "Pistë për aterrim preciz e kategorisë II" në "Pistë për aterrim preciz e kategorisë IIIb".

- Projekti i linjës së tensionit të lartë në afërsi të Aeroportit të Gjakovës

AAC-ja ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT në lidhje me projektin, e aprovuar më herët nga AAC-ja, të linjës së tensionit të lartë 400 kV Shqipëri – Kosovë, që kalon në zonën afër Aeroportit të Gjakovës.

Inspektorët e AAC-së kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e KOSTT-it, të cilëve iu është dhënë përkrahja profesionale në interpretimin e kërkesave për shenjimin e pengesave në përpunime me Rregulloren nr. 2/2010 të AAC-së për shenjimin e pengesave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/2013.

Në muajin prill, inspektorët e AAC-së kanë inspektuar dhe verifikuar shenjimin dhe ngjyrosjen e linjës së tensionit të lartë dhe kanë vlerësuar se KOSTT-i i ka ekzekutuar punimet në përpunime me projektin e aprovuar nga AAC-ja, përfshirë ngjyrosjen e shtyllave, vendosjen e sferave kuq-bardhë dhe ndriçimin e shtyllave të linjës 400kV, Kosovë-Shqipëri.

- Mbikëqyrja e ndërtimeve në zonën mbrojtëse të aeroportit

Në kuadër të përgjegjësiave për rregullimin e zonave mbrojtëse të aeroportit, AAC-ja ka vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores nr. 5/2010 për zonat mbrojtëse të aeroportit, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 4/2016 dhe Rregulloren nr. 2/2010 për shenjimin e pengesave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/2013.

Gjatë vitit 2016, janë pranuar nga ANP “Adem Jashari” LKIA disa vlerësime të aplikacioneve për ndërtime brenda zonave mbrojtëse të aeroportit, siç është një objekt reklame nga kompania “Albanian Display” në fshatin Harilaq të Fushë Kosovës, dislokimi i shtyllave të ndriçimit pranë heliporteve të KFOR-it dhe vendosja e një antene për nevoja të KFOR-it. AAC-ja ka vlerësuar në hollësi dokumentacionin e pranuar dhe, pasi është siguruar që ndërtimet nuk do të ndikojnë në sigurinë e operimeve të aviacionit civil, ka lëshuar aprovimet.

Më 20 tetor 2016, një kompani gjermane ka kërkuar nga AAC-ja vlerësimin e projekt-propozimit për instalimin e kantierit të gjeneratorëve të erës në fshatin Selac, bjeshkët e Bajgorës, për pengesat eventuale që këta gjeneratorë mund të shkaktojnë në operimet e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Pas bashkëpunimit të ngushtë në mes të Departamentit të Aerodromeve dhe atij të Shërbimit të Navigacionit Ajror në AAC, dhe bazuar në vlerësimet preliminare të pranuar nga ANP “Adem Jashari” dhe ASHNA, është dhënë pëlqimi preliminar më 16 nëntor 2016 lidhur me projektin e propozuar. Aplikuesi është udhëzuar lidhur me kërkesat dhe kushtet të cilat duhet t’i plotësojë, bazuar në legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, për t’u pajisur me pëlqimin përfundimtar për realizimin e këtij projekti.

Në kuadër të këtij vlerësimi dhe pas instalimit të shtyllave me instrumente meteorologjike për matje të erës, më herët të aprovuara nga AAC-ja, inspektorët e aerodromeve kanë bërë verifikimin në terren për të konfirmuar përmbushjen e kërkesave për shenjim të objekteve të larta bazuar në kërkesat në fuqi. AAC-ja do të vazhdojë me përcjelljen e zbatimit të këtij projekti.

- Vlerësimi i kërkesave për ndërtimin e heliporteve

Janë pranuar tri kërkesa-shprehje të interesit për ndërtim të heliporteve: një në kompleksin e “Spitalit Amerikan” në Prishtinë, një tjetër në Komunën e Podujevës dhe një në Komunën e Pejës. Përderisa kërkesa e parë ka pasur të bëjë me ofrimin e shërbimeve emergjente mjekësore, dy të tjerat kanë pasur qëllim zhvillimin e aktiviteteve rekreative.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha kërkesave, AAC-ja ka udhëzuar palët e interesuara dhe iu ka prezantuar të gjitha kërkesat dhe standardet që duhet të plotësohen për t’u pajisur me aprovimin e heliportit, bazuar në Rregulloren nr. 3/2012 të AAC-së mbi aerodromet e aprovuara.

- Aprovimi i trajnimeve profesionale të LKIA-së

Bazuar në Rregulloren nr. 1/2014 të AAC-së mbi aftësimin profesional të punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aerodromit, të cilët vetë kryejnë shërbime në tokë, LKIA ka aplikuar për aprovim të trajnimeve profesionale për shërbimet e ndryshme në aeroport, si: shërbimet e bagazhit, shtyrjes/tërheqjes së aeroplanëve, marshallimit, lëvizjes së aeroplanëve, operimet e mjeteve në platformë, operimin me urat për hyrje të udhëtarëve në aeroplan, etj. Në kuadër të këtij procesi, Departamenti i aerodromeve ka bërë vlerësimin e dokumentacionit të pranuar dhe ka mbajtur takime të vazhdueshme me operatorin. Pas vlerësimit të dokumentacionit, AAC-ja ka dhënë pëlqimin për këto programe trajnimesh.

d) Rregullimi ekonomik

AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Rregullimi ekonomik i këtyre operatorëve nënkupton masat që merr një rregullator i aviacionit për t'u siguruar se tarifat të cilat i vendos aeroporti dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror për kompanitë ajrore janë të vendosura në mënyrë të arsyeshme, transparente dhe jodiskriminuese. Për më tepër, rregullatori siguron që këto tarifa janë vendosur vetëm pasi që ofruesit dhe shfrytëzuesit e shërbimeve janë konsultuar mes veti duke i ofruar njëri-tjetrit të dhëna në mënyrë transparente. AAC-ja i rregullon dhe i miraton vetëm tarifat aeronautike, të cilat kanë lidhje me shërbimet të cilat aeroporti dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror i ofrojnë ekskluzivisht, pa pasur kurrfarë konkurrence, siç janë tarifa e shërbimit të udhëtarëve, tarifa e aterrimin apo ajo terminale e navigacionit. Poashtu, rregullatori mbikëqyr nëse qëndrueshmëria financiare e operatorëve është në nivel të duhur që të mos e dëmtojë sigurinë e operimeve.

- Mbikëqyrja ekonomike e aeroportit

Analiza e pasqyrave të audituara financiare të operatorit të ANP "Adem Jashari" për gjendjen financiare në fund të vitit 2015 ka vërtetuar afarizmin pozitiv dhe qëndrueshmërinë financiare të aeroportit. Gjithashtu, është vërtetuar se polica e sigurimit, me mbulim adekuat për dëmet që mund t'i shkaktojë aeroporti, është zgjidhur me kohë. Ky është një element tjetër i rëndësishëm i mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve në fushën e aviacionit civil.

Pas vlerësimit të propozimit të operatorit të aeroportit, më 15 shkurt 2016, AAC-ja ka miratuar Programin Nxitës 2016-2018 për ANP "Adem Jashari", i cili u është ofruar të gjitha kompanive ajrore që operojnë apo planifikojnë të operojnë në këtë aeroport. Ky program nxitës është i vlefshëm prej datës 27 mars 2016 deri më 24 mars 2018. Vendimi për miratim, së bashku me programin nxitës, janë publikuar në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

Programi nxitës 2016-2018 përmban këto nxitje:

1. Nxitja për kompanitë ajrore që hapin destinacione të reja;
2. Nxitja për kompanitë ajrore që hapin frekuenca të reja;
3. Nxitja për kompanitë ajrore që rrisin vëllimin ekzistues të trafikut;
4. Nxitja për kompanitë ajrore që stacionojnë së paku një aeroplan në Prishtinë;
5. Nxitja për kompanitë ajrore që operojnë në orare që janë më pak të ngarkuara (off-peak);
6. Mbështetja për aktivitete marketingu kompanive që hapin destinacione apo frekuenca të reja.

Kompanitë ajrore të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në program mund të aplikojnë për një apo më shumë nxitje financiare. Varësisht prej llojit të nxitjes për të cilën aplikojnë, kompanitë ajrore mund të përfitojnë përjashtim të plotë nga pagesa e tarifës së aterrimin për dy vite, për shembull nëse hapin ndonjë destinacion ose frekuencë të re, apo mund të përfitojnë kompensim financiar



për secilin udhëtar shtesë që bartin nga Prishtina sipas një skeme të precizuar në programin nxitës. Vendimi i AAC-së për të miratuar këtë program nxitës ka ardhur pasi që është siguruar, veç tjerash, se kushtet e propozuara nga operatori i aeroportit që kompanitë ajrore duhet t'i plotësojnë për të përfituar nxitje nuk janë diskriminuese. AAC-ja poashtu është siguruar se operatori i aeroportit është konsultuar lidhur me nxitjet e propozuara me kompanitë ajrore që operojnë në Prishtinë, në pajtim me Rregulloren nr. 3/2015 të AAC-së mbi tarifat e aeroportit. Nxitjet financiare janë praktikë që rëndom përdoren nga operatorët e aeroporteve në Evropë për të stimuluar rritjen e trafikut të udhëtarëve.

Drejtori i përgjithshëm i AAC-së është ftuar në takimin e Komitetit për Partneritet Publiko-Privat të datës 9 mars 2016 për të prezantuar Programin Nxitës 2016-2018 të ofruar në ANP "Adem Jashari" dhe të miratuar nga AAC-ja më 25 shkurt 2016. Drejtori i përgjithshëm ka dhënë detaje, jo vetëm mbi procedurën administrative të ndjekur gjatë miratimit, por edhe mbi kostot si dhe përfitimet financiare që gjenerohen me aplikimin e këtij programi.

- Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s

Në fillim të vitit 2016, Ndërmarrja Publike ANP "Adem Jashari" – Kontrolli Ajror është shndërruar në agjenci qeveritare përmes Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë për Shërbimet e Navigacionit Ajror (ASHNA). AAC-ja ka pranuar dhe analizuar raportet e audituara financiare për vitin 2015 të ndërmarrjes publike, që ka operuar deri në fund të këtij viti. Kompania audituese ka dhënë një opinion të kualifikuar mbi një numër çështjesh të paraqitura në raportin financiar të NP ANP "Adem Jashari" – Kontrolli Ajror, të cilat nuk ka mundur t'i vërtetojë, ose me të cilat nuk është pajtuar. Në bazë të pasqyrave të audituara financiare rrjedh se ndërmarrja publike në fjalë nuk ka pasur qëndrueshmëri të duhur financiare sepse, mes arsyeve tjera, ka trashëguar raste ligjore me implikime të konsiderueshme financiare. Shndërrimi i saj në agjenci qeveritare prej datës 1 janar 2016 e kualifikon atë për marrjen e granteve qeveritare meqë është pjesë e buxhetit të konsoliduar të Republikës së Kosovës dhe ky status pritet të ndihmojë ASHNA-n në realizimin e investimeve kapitale.

Më 25 shkurt 2016 ka hyrë në fuqi Rregullorja nr. 3/2016 e AAC-së mbi skemën e përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror. Kjo rregullore transponon në rendin tonë ligjor Rregulloren nr. 1794/2006 të BE-së me të njëjtin emër, e cila bën pjesë në paketën legislative SES I (*ang. Single European Sky, sq. Qielli i Vetëm Evropian*). Rregullorja i mundëson ASHNA-s që përmes një tarife që iu ngarkon kompanive ajrore të mbledhë buxhetin e nevojshëm për t'i mbuluar kostot operationale dhe të tjera që shkaktohen gjatë ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror për aeroplanët që fluturojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Kjo tarifë propozohet nga ASHNA dhe miratohet

çdo vit nga AAC-ja për vitin pasues. Në zbatim të kësaj Rregulloreje, më 30 dhjetor 2016, Drejtori i përgjithshëm i AAC-së, përmes Vendimit Ekzekutiv nr. 11/ZDP/VE/2016, ka përcaktuar vlerën e tarifës njësi terminale në Republikën e Kosovës, të aplikueshme nga data 1 janar 2017. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Nën parashikimin e ngritjes për 10% të numrit të njërive të shërbimit gjatë vitit 2017, kostot totale të miratuara nga AAC-ja për ASHNA-n arrijnë shumë prej afro 3.7 milion Euro. AAC-ja ka marrë vendim pasi që ka shqyrtuar dy propozime nga ASHNA për vlerën e tarifës njësi në vitin 2017 si dhe pas konsultimit me kompanitë ajrore, në pajtim me Rregulloren nr. 3/2016. Zbatimi i kësaj rregulloreje pritet të promovojë nxitjen e efikasitetit financiar dhe operacional të Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës.

Në lidhje me sigurimin nga rreziku që është kërkesë për çdo ofrues shërbimesh të certifikuar, ASHNA ka dëshmuar që ka një policë adekuate të sigurimit, të vlefshme për vitin 2016, për të mbuluar përgjegjësinë e saj ndaj dëmeve që mund t'u shkaktohen kompanive ajrore dhe palëve të treta, gjatë ekzekutimit të shërbimit.

- Mbikëqyrja ekonomike e shërbyesve në tokë

Në ANP operojnë dy ofrues të shërbimeve në tokë, të cilët janë miratuar nga AAC-ja për këtë qëllim: operatori i ANP "Adem Jashari", LKIA, si ofrues i një game të gjerë shërbimesh (shërbimet e udhëtarëve, përpunimin e bagazhit, të aeroplanit në tokë etj.) si dhe kompania "Ex Fis" sh.p.k., e cila bën furnizimin e aeroplanëve me derivate. Të dy operatorët janë në mbikëqyrje të vazhdueshme nga AAC-ja për mirëmbajtjen e kritereve të sigurisë dhe atyre ekonomike.

Të dy këto kompani, përmes raporteve të auditorëve të pavarur, të shqyrtuara nga AAC-ja, kanë demonstruar gjendje stabile financiare gjatë vitit 2015 dhe, për më tepër, kanë demonstruar përmbushjen e nenit 4 të Rregullores nr. 4/2011 të AAC-së mbi shërbimet në tokë, sipas të cilit kërkohet që, në rastet kur operatorët japin edhe shërbime të tjera, atëherë llogaritë financiare nga aktiviteti i shërbimit në tokë duhet të jenë të ndara nga aktivitetet tjera që ata bëjnë.

Gjithashtu, është vërtetuar që "Ex Fis" sh.p.k. është pajisur me policë të sigurimit dhe ka mbulesë të vlefshme për dëmtimet që mund t'ua shkaktojë palëve gjatë ekzekutimit të shërbimit.

7.11 AKTIVITETI LEGJISLATIV

AAC-ja dallohet nga një numër i agjencive tjera të pavarura për shkak të kompetencave të saj legjislative. Në bazë të kompetencave të dhëna në Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, AAC-ja është e autorizuar të nxjerrë akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil, me të cilat bëhet përvetësimi i standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil (të njohura si Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara "SPR" e anekseve të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil - Konventa e Çikagos) dhe të atyre për zbatim të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit civil, si ato në kuadër të Marrëveshjes HPEA, ashtu edhe të tjerat, të cilat vlejnë për vendet e BE-së, por që ende nuk janë bërë zyrtarisht pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Kështu, edhe gjatë vitit 2016, sikur viteve të kaluara, AAC-ja ka vazhduar me nxjerrjen e rregulloreve, me të cilat është bërë i mundur përvetësimi i disa standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil në Republikën e Kosovës si dhe rregullimi i disa fushave tjera me rëndësi për aviacionin civil në vend. AAC-ja ka projektuar një model të përvetësimit të këtyre standardeve, i cili ka munguar në praktikën e legjislacionit në vend dhe më gjerë. SPR-të e Konventës së Çikagos janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës përmes Ligjit për Aviacionin Civil, por duke marrë parasysh se secili nga këto standarde përmban pjesë të cilat mund të mos jenë të aplikueshme në vendin tonë (p.sh. operimet e hidroplanëve në det), të cilat rrjedhimisht duhet të përjashtohen, AAC-ja ka projektuar modelin e përvetësimit të atyre standardeve që mund të aplikohen, duke përjashtuar njëkohësisht ato të cilat nuk janë të aplikueshme. Për më tepër, me qëllim të rritjes së standardeve të sigurisë, përmes rregulloreve implementuese të AAC-së, është bërë i obligueshëm zbatimi i një numri të madh të praktikave të

rekomanduara të ICAO-s, të cilat nuk janë të detyrueshme për shtetet. Ky model është në pajtim me Konventën e Çikagos. Në këtë mënyrë janë bërë të zbatueshme pothuajse të gjitha SPR-të e Konventës së Çikagos në rendin juridik të Republikës së Kosovës. Me këtë është rrumbullakësuar në masë të konsiderueshme korniza ligjore e rregullimit të aviacionit civil në vendin tonë.

Që nga 1 janari 2016, AAC-ja bën transponimin e legjislacionit të BE-së në përputhje të plotë me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 03/2013, dt. 17/06/2013 të Qeverisë së Kosovës për standardet e hartimit të akteve normative. Kjo nënkupton që secila projekt-rregullore e hartuar nga AAC-ja, që transponon një akt nënligjor të BE-së, duhet të kalojë nëpër procedurën e miratimit nga Ministria e Integriteteve Evropiane para se të nënshkruhet nga Drejtori i përgjithshëm.

a) Aktet nënligjore

AAC-ja aplikon procedurë transparente gjatë nxjerrjes së akteve nënligjore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2012 për procedurat e konsultimit publik. Të gjitha aktet nënligjore të AAC-së i nënshtrohen procesit të konsultimit publik të palëve të interesit. Ky konsultim ndjek procedurat dhe afatet kohore të dhëna, gjatë të cilit, çdo palë interesi, qoftë person fizik apo juridik, ka të drejtën e dhënies së komenteve, sugjerimeve apo të kërimit të informacioneve shtesë nga strukturat e AAC-së, të cilat e nxjerrin një projekt-akt në konsultim publik. Forma e marrjes së këtyre komenteve/sugjerimeve nga palët e interesit mund të jetë me organizim të tryezave të rrumbullakëta, varësisht nga numri i të interesuarve, apo nëpërmes korrespondencës elektronike. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, strukturat e AAC-së brenda 15 ditëve janë të obliguara që të përgatisin një raport, në të cilin do t'i ofrojnë përgjigjet e tyre në komentet e pranuar, ndërsa duhet të shpjegojnë arsyet për pranimin apo mospranimin e sugjerimeve për ndryshim të dispozitave të projekt-aktit nënligjor që është objekt i konsultimit publik.

Publikimi i akteve nënligjore të AAC-së bëhet në platformën elektronike të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

Në vazhdim janë aktet nënligjore, të cilat janë nxjerr gjatë vitit 2016:

- Rregullore nr. 1/2016 për plotësimin e Rregullores nr. 8/2009 për vendosjen e kornizës për krijimin e Qiellit të Vetëm Evropian, Rregullores nr. 9/2009 për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në Qiellin e Vetëm Evropian, Rregullores nr. 10/2009 për organizimin dhe shfrytëzimin e hapësirës ajrore në Qiellin e Vetëm Evropian dhe Rregullores nr. 11/2009 për ndërveprueshmëri të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror evropian;
- Rregullore nr. 2/2016 për zbatimin e Shtojcës 10 në Konventën ndërkombëtare mbi aviacionin civil për telekomunikacionin aeronautik;
- Rregullore nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror;
- Rregullore nr. 4/2016 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 5/2010 mbi zonat mbrojtëse të aeroportit.

Janë hartuar edhe këto projekt-rregullore:

- Projekt-rregullore mbi kërkesat e përdorimit të zakonshëm të hapësirës ajrore dhe procedurat operative për shmangie të përplasjeve ajrore, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 1332/2011.
- Projekt-rregullore për raportimin, analizimin dhe procedimin e mëvonshëm të ndodhivë në aviacionin civil, e cila transponon Rregulloren e (BE) nr. 376/2014.

- Projekt-rregullore mbi metodat e punës së Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit për kryerjen e inspektimeve të standardizimit, si dhe monitorimin e zbatimit të rregullave të Rregullores bazë, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 628/2013.
- Projekt-rregullore për specifikat shtesë të vlefshmërisë ajrore për llojin e dhënë të operimeve, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/640.
- Projekt-rregullore që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative që lidhen me operimet ajrore të operatorëve të vendeve të treta, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 452/2014.
- Projekt-rregullore mbi tarifat dhe detyrimet e vendosura nga Agjencia e Sigurisë së Aviacionit Evropian (EASA), e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 319/2014.
- Projekt-rregullore për trajnimin e pilotëve, testimin dhe kontrollin periodik për navigimin e bazuar në performancë, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 2016/539.
- Projekt-rregullore në lidhje me kërkesat teknike dhe procedurat administrative që lidhen me ekuipazhin e aviacionit civil, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/445.
- Projekt-rregullore në lidhje me operimet nga transportuesit ajrorë të Bashkimit Evropian të mjeteve ajrore të regjistruar në një vend të tretë, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/1329.
- Projekt-rregullore në lidhje me kërkesat për regjistruarit e fluturimit, pajisjet për lokalizim nënujor dhe sistemet për gjurmimin e mjeteve ajrore, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/2338.
- Projekt-rregullore në lidhje me fluturimet testuese, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/1039.
- Projekt-rregullore në lidhje me implementimin e kërkesave themelore për mbrojtjen e mjedisit, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 2016/5.
- Projekt-rregullore për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot e cila zhvlerëson Rregulloren nr. 6/2014 për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot me peshë më të vogël se 20 kg.
- Projekt-rregullore që përcakton listën që klasifikon ndodhitë në aviacionin civil që detyrimisht raportohen në bazë të Rregullores (BE) nr. 376/2014, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/1018.
- Projekt-rregullore që përcakton rregullat e përbashkëta në ajër dhe dispozitat operative në lidhje me shërbimet dhe procedurat e navigimit ajror, e cila e transponon Rregulloren (BE) nr. 923/2012.
- Projekt-rregullore mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë Evropiane për Sigurinë e Aviacionit, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 6/2013 dhe përditëson Rregulloren e AAC-së nr. 3/2009.
- Projekt-rregullore që përcakton rregullat e hollësishme për gjobat dhe pagesat periodike, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 646/2012.
- Projekt-rregullore që vendos rregullat e përbashkëta për menaxhimin e fluksit të trafikut ajror, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 255/2010

- Projekt-rregullore për kërkesat dhe procedurat administrative që kanë të bëjnë me aerodromet, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 139/2014.

Projekt-rregulloret e listuara më lartë pritet të hyjnë në fuqi gjatë vitit 2017.

b) Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative

Në vijim janë listuar vendimet ekzekutive dhe ato administrative të lëshuara nga Drejtori i përgjithshëm i AAC-së gjatë vitit 2016:

Vendimet ekzekutive

- Vendim nr. 01/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 12 shkurt 2016, për shtyrjen e afatit për zbatim të Kapitullit I dhe II të Rregullores nr. 1/2014, për operatorin e aeroportit;
- Vendim nr. 02/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 15 shkurt 2016, për aprovimin e programit nxitës për ANP "Adem Jashari";
- Vendim nr. 03/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 8 prill 2016, për z. Zlatko Spirkovski;
- Vendim nr. 04/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 13 korrik 2016, për Z. Halil Halili;
- Vendim nr. 05/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 13 korrik 2016, për z. Drin Gashi;
- Vendim nr. 06/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 31 gusht 2016, për z. Erland Dalliu;
- Vendim nr. 07/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 5 shtator 2016, për z. Xhelal Tetaj;
- Vendim nr. 08/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 21 shtator 2016, për z. Musli Mehmeti;
- Vendim nr. 09/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 10 tetor 2016, për operatorin "Kosovo Air Service";
- Vendim nr. 10/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 16 dhjetor 2016, që refuzon tarifën njësi terminale për vitin 2017 të propozuar nga ASHNA;
- Vendim nr. 11/ZDP/VE/2016, i lëshuar më 30 dhjetor 2016, që përcakton tarifën njësi terminale për vitin 2017.

Vendimet administrative

- Vendim nr. 01/2016, i lëshuar më 4 mars 2016, për ndryshimin e akt emërimit të znj. Safete Selmani nga Zyrtare për burime njerëzore në Menaxhere të personelit;
- Vendim nr. 02/2016, i lëshuar më 31 mars 2016, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së z. Ylber Aliu;
- Vendim nr. 03/2016, i lëshuar më 1 prill 2016, mbi emërimin e znj. Shqipe Krasniqi-Selishta ushtruese e detyrës së Drejtoreshës së Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore;
- Vendim nr. 04/2016, i lëshuar më 11 maj 2016, për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 15/2012 për emërimin e ekipit të auditimit të brendshëm të sistemit për menaxhimin e cilësisë;
- Vendim nr. 05/2016, i lëshuar më 17 maj 2016, për caktimin e zyrtarëve financiarë për ushtrimin e detyrave shtesë të menaxhimit të shpenzimeve të AAC-së;
- Vendim nr. 06/2016, i lëshuar më 3 tetor 2016, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së z. Eset Berisha;
- Vendim nr. 07/2016, i lëshuar më 18 nëntor 2016, për autorizimin e pushimit pa pagesë për z. Naser Grajçevci;
- Vendim nr. 08/2016, i lëshuar më 13 dhjetor 2016, për emërimin e Komisionit për rekrutim;
- Vendim nr. 09/2016, i lëshuar më 13 dhjetor 2016, për emërimin e Komisionit për rekrutim.

c) Ndëshkime/ankesa/konteste

Vendimet ekzekutive të përmendura më lart, me nr. 04-07, përmbajnë gjoba për operim të paautorizuar të dronëve dhe janë paguar nga të gjithë personat, ndërsa vendimi nr. 08 përmban gjobë për operim të paautorizuar të mjetit ajror mikro të lehtë dhe nuk është paguar deri në përmbylljen e vitit. Ankesa dhe konteste nuk ka pasur.

7.12 PUBLIKIMET TEKNIKE PËR INDUSTRINË

Për t'i përkrahur operatorët në zbatimin e legjislacionit në fuqi, AAC-ja në vazhdimësi nxjerr publikime teknike për industrinë e aviacionit civil. Gjatë këtij viti është publikuar një manual i ri udhëzues dhe janë mbajtur të përditësuar të gjithë manualët tjerë të publikuar nga AAC-ja, pas ndryshimeve legjislative që kanë ndodhur gjatë vitit në legjislacionin ku bazohen manualët. Publikimi i ri është:

- Publikimi Teknik 26 – Sistemi për menaxhim të sigurisë për ofruesit e shërbimeve

Janë publikuar versionet e reja të publikimeve teknike:


- Publikimi Teknik 02 – Certifikimi i aerodromeve
- Publikimi Teknik 03 – Zonat mbrojtëse të aerodromeve
- Publikimi Teknik 07 – Certifikata e operatorit ajror
- Publikimi Teknik 08 – Ndërtimet në aerodrom.

Ndërsa janë reviduar:

- Publikimi Teknik 18 – Kriteret dhe procedurat për lëshimin e aprovimit të shërbimeve në tokë
- Publikimi Teknik 20 – Menaxhimi i rrezikut të goditjeve nga bota shtazore në aerodrom
- Publikimi Teknik 21 – Menaxhimi i rrezikut në platformë.

- Publikimi i pasqyrës mbi ndodhitë e raportuara

Në fillim të vitit 2016, AAC-ja ka publikuar raportin “Pasqyra e Ndodhive të Raportuara 2015”, në të cilin janë përmbledhur të gjitha ndodhitë e raportuara në AAC gjatë vitit 2015. Në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, “ndodhia” nënkupton një pengesë operationale, defekt, gabim apo rrethana të tjera të parregullta që ka ndikuar apo do të mund të ndikonte në sigurinë e fluturimit.



Ndodhitë e raportuara në AAC sipas muajve gjatë vitit 2015

Gjatë vitit 2015 në AAC janë raportuar gjithsej 132 ndodhi, të cilat janë klasifikuar dhe kategorizuar varësisht nga ndikimi në sigurinë e aviacionit si dhe nga natyra e tyre. Këto raportime janë bërë nga personeli i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” LKIA, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, KFOR-i dhe nga kompanitë ajrore. “Pasqyra e Ndodhive të Raportuara” përmban statistikën e këtyre ndodhive, një përshkrim të shkurtër për secilën kategori të ndodhive, si dhe përshkrimin e disa ndodhive të përzgjedhura.

Dokumenti “Pasqyra e Ndodhive të Raportuara 2015” mund të gjendet në faqen zyrtare të AAC-së në internet www.caa-ks.org.

7.13 INFORMIMI I PUBLIKUT DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

a) Buletini i AAC-së “Aviatori”

Autoriteti i Aviacionit Civil publikon buletin e përmuajshëm “Aviatori”, me theks në zhvillimet në AAC dhe industrinë e aviacionit në përgjithësi. Gjatë vitit 2016 janë publikuar gjithsej 10 numra të këtij bulletini, i cili u është shpërndarë institucioneve të Kosovës, industrisë dhe publikut të gjerë në mënyrë elektronike përmes email-it dhe faqes zyrtare të AAC-së në internet.

b) Qasja në dokumente publike

Përmes Vendimit nr. 19/2012, Drejtori i përgjithshëm ka emëruar zyrtarin për komunikim me publikun, në të njëjtën kohë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të personave juridikë dhe fizikë për qasje në dokumentet publike të AAC-së, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Gjatë vitit 2016 janë pranuar 3 kërkesa për qasje në dokumente publike. Të gjitha kërkesat janë përmbushur brenda afatit ligjor. Nga kërkuarit e qasjes, një ka qenë nga mediet, një nga shoqëria civile dhe një nga biznesi. Sipas kategorive, një kërkesë ka qenë për statistika, një për dronët dhe një për të punësuarit me kontratë për shërbime të veçanta.

c) Faqja zyrtare e AAC-së në internet

Në shtator, AAC-ja ka lansuar faqen e saj të re në internet. Ridizajnimi i faqes ka mundur organizim më të mirë të materialit të vënë në dispozicion për publikun dhe njëkohësisht ka aktualizuar atë në hap me zhvillimet teknologjike në këtë fushë, duke filluar nga siguria kibernetike dhe përshtatja e përmbajtjes së shfaqur për ekranet e ndryshme, siç janë ato të pajisjeve mobile.

7.14 ADMINISTRATA DHE BURIMET NJERËZORE

Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore, si njësi mbështetëse në AAC, ka mbështetur aktivitetet rregullatore të AAC-së, duke zbatuar procedurat për burimet njerëzore, financat, prokurimin, logjistikën dhe arkivin. Për të siguruar një punë efikase, në vazhdimësi është përcjell nxjerrja e legjislacionit të ri dhe ndryshimet e legjislacionit në fushën e administratës publike në Republikën e Kosovës. Më pas është informuar stafi i AAC-së dhe është përditësuar Manuali i procedurave të brendshme të administratës për t'i reflektuar ndryshimet.



Pamja e Buletinit të muajit nëntor 2016

a) Prokurimi gjatë vitit 2016

Aktivitetet e realizuara të prokurimit	Emri i Operatorit Ekonomik të cilit i është dhënë kontrata	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e kontratës
Autoriteti Qendror i Prokurimit (AQP) – Nivel Qendror Kontratë publike kornizë për furnizim me karburante	HIB PETROL	11.02.2016 - 11.02.2019	Premiumi për karburante 0.055 € Kontratë 36 muaj
Sigurimi fizik i objektit dhe i pasurisë së AAC-së, me një post (rojë)	Body Guard	31.03.2016	950.40 €
Sigurimi fizik i objektit dhe i pasurisë së AAC-së, me një post (rojë)	LUANI SH.P.K.	03.05.2016	29,997.00 € Kontratë 36 muaj
Furnizim me ujë	ADEA GROUP Sh.P.K.	24.05.2016	670.00 € Kontratë 12 muaj
Shërbime teknike për dizajn dhe shtyp	EUROPRINTY SH.P.K.	13.06.2016	2,449.00 € Kontratë 12 muaj
Shërbimet e sigurimit të tri veturave zyrtare të AAC-së (Kasko e plotë, TPL dhe TPL+)	KS ILLYRIA SH.A.	03.06.2016	989.52 € Kontratë 12 muaj
AQP – Nivel Qendror Kontratë publike kornizë për furnizim me material për zyrë LOT 1	NTG BLENDI & NTL RILINDJA	04.08.2016 - 04.08.2019	1724.40 € Kontratë 36 muaj
AQP – Nivel Qendror Kontratë publike kornizë për furnizim me material për zyrë LOT 2	EUROPRINTY SH.P.K.	04.08.2016 - 04.08.2019	2338.29 € Kontratë 36 muaj
AQP – Nivel Qendror Kontratë publike kornizë për shërbime të transportit ajror	ALTAVIA TRAVEL & AS TRAVEL	04.08.2016 - 04.08.2019	1.27 € (fitimi në biletë) Kontratë 36 muaj
AQP – Nivel Qendror Kontratë publike kornizë për furnizim me goma	EUROGOMA SH.P.K.	04.08.2016 - 04.08.2019	1,230 € Kontratë 36 muaj

AQP – Nivel Qendror Kontratë publike kornizë për furnizim me material higjienik LOT II	BENI DONA PLAST SHPK & PERFECT BLUES	09.08.2016 - 09.08.2019	4,709.20 € Kontratë 36 muaj
